

BULETINI I SHKENCAVE GJEOLLOGJIKE

VITI XII (XXIX) I BOTIMIT

**1
1995**

TIRANE

TREGUESI I LENDES (CONTENTS)

ORE DEPOSITS RELATED VOLCANISM

(VENDBURIMET XEHERORE TE LIDHURA ME VULLKANISMIN)

D. Kolndre - Copper Deposits Relation to Vortex and Wrench Faulting System in Eastern Ophiolitic Complex of Central Mirdita, Albania. (Vb e bakrit te lidhura me sistemet rrotulluese dhe te thyerjeve ne kompleksin lindor te Ofioliteve te Mirdites Qendore ne Shqiperi....faqe 5	
M. Koçi - Gold-bearing in Copper ore deposits of Mirdita Zone (North Albania). (Permbajtja e arit ne vendburimet e bakrit te zones Mirdita).....faqe 7	
H. Noka - Mbi formacionin sedimentar vullkanogjene te freatit te Kukesit. (The volcano-sedimentary Formation of Kukes-North Eastern Albania).....faqe 13	
I. Milushi, V. Bezhani - Mineralizimet e bakrit qe lidhen me ofiolitet Shqiptare (Copper sulphide Mineralizations related to Volcanites of Albanian Ophiolites).....faqe 23	
A. Sinoimeri - Several sea-Floor Mineralization Levels in Volcanogenic Sequence of Central Mirdita, Albania. (Nivelet e mineralizimeve te fundit te detit ne sekuencen vullkanogjene te Mirdites Qendore).....faqe 37	
L. Hoxha - Sulphide Mineralizations of Albanian Ophiolite Volcanics. (Mineralizimet sulfide te vullkaniteve te ophioliteve te Shqiperise).....faqe 39	
J. Hoxha, H. Kuçi - Vullkanizmi i zones Gashit, ndryshimet e tij me vullkanizmat e tjere ne Albanide. (The volcanism of Gashi zone and its Difference from other volcanisms)faqe 65	

MAGMATIZMI NE PLLAKA (MAGMATISM WITHIN PLATES)

A. Tashko, V. Pajcini, F. Siena - Perberja e fluideve te inkluzioneve ne ksenolitet e peridotiteve mantelore (ishujt Kanarieve). Nje studim me mikrospektrometrine Raman dhe Mikrotermometri. (Fluid composition of Inclusions in Mantle xenoliths peridotites (Canary Islands). A Raman Microspectrometric and Mikrothermometric Study).....faqe 75	
--	--

OFIOLITET E TETISIT (TETHYAN OPHIOLITES)

Bonneau M., Cadet J.P, Malusci H., Ivanaj A - ^{40}Ar . ^{39}Ar Ages of the Eastern Ophiolitic sole of the Mirdita Nappe. (Moshat e dherave te Mbuleses Mirdita)faqe 83	
K.Gjata., A.Kodra - Pikrite ne periferine e Ophioliteve dhe ne buzet kontinentale te tyre. (Picrites occurring in the Periphery of Ophiolites and their continental Margins).....faqe 85	
M.Shallo - Volcanics and sheeted Dykes of the Albanian SSZ Ophiolite. (Dajkat vullkanike dhe ato paralele te Ophioliteve SSZ te Shqiperise).....faqe 99	
A.Kodra., K.Gjata., F.Bakalli - Vullkanizmi Mesozoik ne Shqiperi (Zona e Mirdites (Mesozoic Volcanism in Albania).....faqe 119	
I. Turku - The Paleozoic and Mesozoic volcanism of Albania (Vullkanizmi Paleozoik dhe Mesozoik ne Shqiperi).....faqe 131	
P. Kalina., K. Pojani, P. Kita - Data on Morphological-Structural Features of Copper Deposits of Rehova. (Te dhena morfologo-strukturore per vendburimin e bakrit Rehove ne sekuencat vullkanike te ofioliteve jugore te Shqiperise).....faqe 131	

ARTIKUJ TE TJERE**GJELOGJIA E VENDBURIMEVE TE KROMIT
GEOLOGY OF CHROMITE DEPOSITS**

M.Hoxha - Të chena petro-mikrostrukturalet qe intensiteti i detemimit ne shkembe të masivit ultrabazik te Kukësit. Petro-microstructure data are intensiv detemimi i masivit ultramafic rocks of Kukës.

A. Beqiri, L. Hodobashi - Aspektet te ndertimit morfolo-struktoror dhe te përcaktim fushes xeherore Thëken-ernove-Pvili Zi. Some aspects of morphological setting and the perspective of the ore field of Theken-Ernove-Pvili Zi.pse 147

AKTIVITETE SHKENCORE AKTUALE

Konferenca Shkencore Nderkompetare mbi Ofioliteve e Shqiperise dhe Mineralizimet qe idhen me to. (Workshop on Albanian Ophiolites and Related Mineralization) ...pse 157

Pranë këtij konferenca s'ka qenë organizuar një panel diskutimi me temën "Geologjia e Vendburimeve te Kromit". Në këtë panel kanë qenë diskutuar: 1. Geologjia e Vendburimeve te Kromit (M. Hoxha); 2. Aspektet te ndertimit morfolo-struktoror dhe te përcaktim fushes xeherore Thëken-ernove-Pvili Zi. (A. Beqiri, L. Hodobashi); 3. Perspektive e zhvillimit të shkencës gjeologjike (L. Hodobashi).

Në këtë panel kanë qenë diskutuar: 1. Geologjia e Vendburimeve te Kromit (M. Hoxha); 2. Aspektet te ndertimit morfolo-struktoror dhe te përcaktim fushes xeherore Thëken-ernove-Pvili Zi. (A. Beqiri, L. Hodobashi); 3. Perspektive e zhvillimit të shkencës gjeologjike (L. Hodobashi).

Në këtë panel kanë qenë diskutuar: 1. Geologjia e Vendburimeve te Kromit (M. Hoxha); 2. Aspektet te ndertimit morfolo-struktoror dhe te përcaktim fushes xeherore Thëken-ernove-Pvili Zi. (A. Beqiri, L. Hodobashi); 3. Perspektive e zhvillimit të shkencës gjeologjike (L. Hodobashi).

Në këtë panel kanë qenë diskutuar: 1. Geologjia e Vendburimeve te Kromit (M. Hoxha); 2. Aspektet te ndertimit morfolo-struktoror dhe te përcaktim fushes xeherore Thëken-ernove-Pvili Zi. (A. Beqiri, L. Hodobashi); 3. Perspektive e zhvillimit të shkencës gjeologjike (L. Hodobashi).

Në këtë panel kanë qenë diskutuar: 1. Geologjia e Vendburimeve te Kromit (M. Hoxha); 2. Aspektet te ndertimit morfolo-struktoror dhe te përcaktim fushes xeherore Thëken-ernove-Pvili Zi. (A. Beqiri, L. Hodobashi); 3. Perspektive e zhvillimit të shkencës gjeologjike (L. Hodobashi).

Në këtë panel kanë qenë diskutuar: 1. Geologjia e Vendburimeve te Kromit (M. Hoxha); 2. Aspektet te ndertimit morfolo-struktoror dhe te përcaktim fushes xeherore Thëken-ernove-Pvili Zi. (A. Beqiri, L. Hodobashi); 3. Perspektive e zhvillimit të shkencës gjeologjike (L. Hodobashi).

Në këtë panel kanë qenë diskutuar: 1. Geologjia e Vendburimeve te Kromit (M. Hoxha); 2. Aspektet te ndertimit morfolo-struktoror dhe te përcaktim fushes xeherore Thëken-ernove-Pvili Zi. (A. Beqiri, L. Hodobashi); 3. Perspektive e zhvillimit të shkencës gjeologjike (L. Hodobashi).

ORE DEPOSITS RELATED TO VOLCANISM

COPPER DEPOSITS RELATION TO VORTEX AND WRENCH FAULTING SYSTEM IN EASTERN OPHIOLITIC COMPLEX OF CENTRAL MIRDITA, ALBANIA

DEDE KOLNDREU

Geological Enterprise, Rubik, Albania

In the "axis" of the ophiolitic complex as a result of the acting of counterclockwise forces are developed the tectonic structures of various shear and rotational shear types (Riedel-shear zones, vortex and wrench folds and faulting system).

The copper deposits (which are found) lie close to each other in "chain-link" formations and are controlled by Landa (λ) type structures such as F1, F2 etc (the ore bodies are controlled by the lower order wrench faulting structures). The Roedel-shear zones and the vortex and wrench faulting system was favourable factor for the transport of fluids and to localise the sulphide minerals.

The main sulphide formations are pyritic ores and vein or vein-like metasomatic replacements.

Generally the copper ore bodies have in plan also in cross-section the reserved S-shaped vortex structure, the Landa and Ksia shapes.

GOLD-BEARING IN COPPER ORE DEPOSITS OF MIRDITA ZONE (NORTH ALBANIA)

Marie Koçji

Institute of Geological Researches Tirana, Albania

Abstract. Copper deposits in Mirdita zone are situated in volcanic rocks. The main ore minerals are: pyrite, chalcopyrite and sphalerite. Bornite, tenantite, galena, arsenopyrite are in minor amounts.

There are a number of associations of sulphide mineralizations:

1. Pyrite - chalcopyrite
2. Pyrite - chalcopyrite - sphalerite
3. Pyrite - chalcopyrite - sphalerite-tenantite-bornite, galena-barite.

Gold content in such associations is different. In association py-chal-sph-ten-born-galena gold various between 25-495 gr/ton. Main mineral gold-bearing are sphalerite, tenantite, arsenopyrite, chalcopyrite.

Mirdita zone with nearly meridional striling is constituted mainly by ophiolitic complex. This zone belongs to the internal Albanides. Albanides are part of Dinaric-Albanid-Helenid chain, whereas Mirdita zone, part of Albanides is correlated with subpelagonian zone of Helenides and Serbian zone of Dinarides.

Ophiolites of Mirdita zone represents an association of igneous-volcanic and volcano-sedimentary rocks.

Most important sulphide mineralizations are related with volcanogenic rocks, represented by bazalt-hyaloandesite, Rhyolite series.

Up to now the following mineral associations are recognized.

1. Pyrite - chalcopyrite
2. Pyrite - chalcopyrite - sphalerite
3. Pyrite - chalcopyrite-sphalerite-galena, bornite, tenantite, barite.

Main ore minerals are: Pyrite, chalcopyrite, sphalerite.

On the top of volcanic section, polimetalic sulphide-like associations with e high content of sphalerite, galena, tenantite, barite (massive structure in Qaf-Bari, Munella, Gurth-Spaç deposits) are found, (Foto N.1,2,3,4,etc.)

Usually the gold-bearing in pyrite ranges between 1-5 gr/t, in chalcopyrite 1-10 gr/t, in sphalerite 1-53 gr/t, in bornite 2-4 gr/t.

But in polimetalic associations gold-content arrived about 446 gr/t. This high content belong also free grain of gold.

Gold is found associated to sulfides in two kind:

- Free gold grains about micron and less, and
- As emulsion solution included in the sphalerite, chalcopyrite, pyrite, tenantite, and galena.

Also was analysed silver-Ag content and resultes, ratio Au/Ag was reported in table Nr.1.

Tabela Nr.1

Nr.	Ore Deposit	Structure	Element (Gr/T)		Ratio Au/Ag
			Au	Ag	
1	Qafe-Bari	Sphalerite massiv	40.40	>>100	1/2.4
2		Massive ore Pyrit-chalcopyrit. Ten.	446.96	>>100	4.5/1
3		Massive sphalerit-galenit-chalopyrit-pyrit	69.58	>100	1/1.4
4		Massive sphalerit-galenit-chalopyrit-pyrit	41.82	>100	1/2.2
5		Massive sphalerit-galenit-chalopyrit-pyrit	1.47	4.55	1/3
6		Dissaminate	1.98	2.3	1/1.2
7	Munella	Massive ore	6.00	5.4	1.1/1
8		Massive ore	8.44	107	1/13
9		Massive ore	11.50	114	1/10
10		Massive ore	4.41	43.2	1/9
11		Vain ore	1.03	59	1/50
12		Vain ore	0.85	2.35	1/3
13	Gurth-Spaçi	Massive ore	25.50	150	1/6
14		Massive ore	13.70	110	1/8
15		Dissaminate	0.20	1	1/5

R E F E R E N C E S

Betehtin A.G. etc. 1958 - Teksturii i strukturi rud. Moskva.

- Gold 89 in Europe 1989, International Symposium in Europe, France.

Jushko S.A. 1966 - Metodi laboratornovo isledovania rud, Moskva.

Kati P. 1971 - La diffusion du sphalerite dans la zone de Mirdita et la mineralisation sulfide en general. Permb.Stud., 2.

Shallo M. 1970 - De certains aspects genetiques et geologiques des gisements koltchedans vulcanogenes-sedimentaries d'Albanie. Permb. Stud., 2.

Shahov F.N. 1961 - Teksturii rud. Moskva.

- Rudonosnost vullkanogenih formacii. Moskva.

**PERMBAJTJA E ARIT NE VENDBURIMET E BAKRIT
TE ZONES MIRDITA
(Shqiperia Veriore)**

Vendburimet e bakrit te rajonit Mirdita Qendrore-Veriore zhvillohen midis shkembinjve vullkanogjene te cilat jane pjesa perberese e serise ofiolitike te takuar.

Mineralet kryesore xehore qe takohen jane : Piriti, kalkopiriti, sfaleriti, ndersa borniti, tenantiti, galeniti, arsenopiriti etj. takohen ne sasi me te ulet.

Dallohen asociacionet e meposhtme te mineralizimit sulfid:

1. Pirit - kalkopirit
2. Pirit-kalkopirit-sfalerit
3. Pirit-kalkopirit-sfalerit-tenantit-bornit-galenit-barit.

Permbajtja e arit ne keto asociacione eshte e ndryshme. Zakonisht permbajtja e tij luhatet nga 1-5 gr/t, ndersa ne asociacionin pirit-kalkopirit-sfalerit-tenantit-barit-galenit-barit permbajtja e tij arrin vlerat maksimale nga 25-495 gr/t.

Mineralet kryesore ar-mbajtes jane sfaleriti, tenantiti, arsenopiriti, kalkopiriti. Gjithashtu takohen edhe kokriza te lira te arit mikrodispers me permaza deri ne disa mikron. Sasia tjeter e arit lidhet ne trajte emulsionesh te solucioneve te ngurta ose si perzierje izomorfike ne rjeten kristaline te ketyre mineraleve.

Diçiturat e figurave (Captions)

Photo 1

Massive structure. Bornite-Chalcopyrite with Pyrite remains. Qafe-Bari ore deposit.

Photo 2

Massive Sphalerite with Tenantite microcrystalline grains. Gurth-Spaç ore deposit.

Photo 3

Tenantite among the Bornite-Chalcopyrite grounmass. Qafe-Bari ore deposit.

Photo 4

Festoon-spherical Pyrite in Bornite-Chalcopyrite groundmass. Gurth-Spaç ore deposit.

Photo 5

Massive Sphalerite with Tenantite inclusions. In its periphery Chalcopyrite rime is found. Qafe-Bari ore deposit.

Photo 6

Chalcopyrite emulsion solution inside Sphalerite. Munella ore deposit.

Photo 7

Rhyolite. Mirdita zone.

Photo 8

Hyaloandesite. Mirdita zone.

MBI FORMACIONIN SEDIMENTARO-VULLKANOOGJEN TE RRETHIT TE KUKESIT

(Marredheniet me shkembinje rrethues, struktura dhe perspektiva bakermajtese)

HAMIT NOKA

Ndermarrja Minerare e Bakrit, Gjegjan, Kukes.

Ne kete kumtese behen perpjekje per te argumentuar maredheniet e nxehta me kontaktin e shkembinjeve ultrabazike dhe atyre sedimentaro-efuzive ne rrethin e Kukesit, per pozicionin normal te struktura dhe zhvillimin e saj ne JL dhe te perspektives bakermajtese ne kete krah.


I. Veshtrim mbi kushtet gjeologo-tektonike te rajonit ne prag te mineralizimit (Fig.1).

Sipas skemes se percaktuar per fazat e orogjenezes dhe te magmatizmit (14) vullkanitet e Gjegjanit duhet ti perkasin fillimit te zhvillimeve gjeosinklinale. Magma vjen nga pjeset e siperme te mantelit, nepermjet thyerjes paraprijese te Drinit (4), ngjitet lart dhe shkarkohet ne fundin e oqeanit te asaj kohe, thellesija e te cilit duhet te kete qene mbi 2000m. (3).

Kjo thyerje me sa duket zhvillimin e pare (hapja e pare) e fillon ne Permianin e siperm dhe e vazhdon jeten e saje deri ne ditet tona. Fillimisht kjo thyerje ka sherbye si kanal per shfryerjen e efuziveve dhe me vone edhe te intruzioneve ultrabazike.

Per afersine e vendburimit me gryken vullkanike, deshmon nder te tjera edhe prania e shtratimeve te xehoreve te bakrit nen mbulesen vullkanike ose brenda pakos sedimentaro-vullkanogjene. Thellesia e madhe e detit, ne kushtet e nje presioni mbi 200 atmosfera, nuk duhet te kete favorizuar mundesite e shperndarjes se produkteve vullkanike dhe te vete mineralizimit ne distanca te largeta. Prandaj vendburimi i Gjegjanit ka me shume te ngjare te jete produkt i nje vullkani te vetem, ndersa objektet e reja qe priten te zbulohen si ne Bardhoc dhe Morine duhet te lidhen me gryka te tjera vullkanike, te cilat mendojme se kontrollohen nga e njejtta linje çarjeje tektonike. Mbi kete baze teorike mund te pritet qe ndermjet dy grykave vullkanike te kemi koridore qe te mbeten jashte rrezes aktive te aktivitetit vullkanik duke krijuar keshtu kushte qe ne ndonje prerje te mungoje ndonje facie ose dhe fragmente te pakos sedimentaro-efuzive.

Thyerja e Drinit, gjate thyerjes se saj me synim qe te shkarkoj mineralizimet e bakrit, mendojme se ka perparuar drejt lartesive duke çare pas tjetres fillimisht shkembinje e paleozoit, te serise Luma (onglomeratet e serise Verrukano) dhe me pas depozitimet fundrrinore te oqeaneve si dhe prerjen e poshteme te serise sedimentaro-efuzive.



2. Mbi ndertimin gjeologjik te formacionit sedimentaro - vullkanogjen

Poshte-shtroja e formacionit **sedimentaro-vullkanogjene**, perfaqesohet nga shkembinjtë magmatike te llojit ultrabazike, te cilet zene vend ne pjesen perendimore te rajonit. Paraqiten te serpentinizuar, proçes ky qe vende-vende shkon deri ne serpentinizim te plete. Gjithashtu edhe brenda serise, trupa serpentinitike ne trajte pykash tektonike te permasave te ndryshme, takohen ne prerjen e Gjegjanit. Shkembinjtë ultrabazike ne maredhenie me shkembinjtë anesore per gjithesist kane kontakte tektonike, por ne sektore te veçante si ne Surroj (10,11) ruhen dhe maredhenie normale me efekte intruzive. Keta shkembinj perbehen kryesisht nga harzburgite dhe me pak me dunite, lercolite dhe piroksenite.


Pakoja **sedimentaro-vullkanogjene** e Kukesit eshte nje formacion gjeologjik i **formuar ne kondita nenujore** te thellisive te medha (rreth 2000m.). Ne baze te shkalles se metamorfizimit, qe eshte ushtrue mbi keta shkembinj, mendojme se kjo pako mund te ndahet ne dy pjese: a. Pjesa e poshtme ose ajo metamorfsike dhe pjesa e siperme ose ajo e metamorfizuar dobet. Pjesa e poshtme ka nje trashesi qe luhatet nga 200 deri ne 250m. dhe perbehet kryesisht nga rreshpet amfibol-epidot-kloritike dhe klorit sericitike. Ndersa pjesa e siperme ka nje trashesi qe luhatet nga 190 deri ne 260m. dhe qe perbehet nga rreshpet kuarc-argilo-sericitike, here here te hekurizuara, ne brendesine e se ciles permbahen trupat vullkanike. Maredheniet ndermjet ketyre dy pjeseve te kesaj pakoje jane normale, me karakter pajtues dhe pa kufare ndryshimesh ndermjet tyre.

Nga ilojet petrografike te ketyre vullkaniteve me teper mbizotrojne diabazet variolitike, spilitet bajamore, porfinitet diabazike etj. Ne kontakt me trupat xeherore te bakrit verehen ndryshime dyesore, te cilat formojne ne vetevehte facie te reja te kontaktit me perberje karbonai-kuarc-kloritike dhe kuarc-epidot-kloritik te sulfurizuar etj., facie keto qe mund te perdoren edhe si kriter kerkimi. Permasat e trupave vullkanike variojne ne shtrirje nga dhjetra ne qindra metra, ndersa ne trashesi nga 10-15 e deri ne 50-60m. Te kesaj natyre dhe me ndertim thijerzore jane edhe faciet e tjera shkembformuese si dhe vete trupat xeherore te bakrit dhe te hekurit.

Ne prerjen e vendbunimit te bakrit te Gjegjanit takohen 3 horizonte kryesore vullkanitesh (Fig. 2,3). Trupi xeheror i bakrit lidhet me horizontin e mesem. Ne baze te vrojtiveve te bollesishme petrografike, te kryera mbi vullkanitet, mund te nxjemim disa perfundime te rendesishme:

a. Shkalla e kristalizimit per mineralet kryesore shkembformues ne çdo trup vullkanik, ne sensin nga tabani per ne tavan, vjen gradualisht duke u zgjedhur.

b. Ne nivelet me tesiperme te çdo trupi vullkanik shfaqet nje shkalle e late albitizimi, e cila kushtezon dhe formimin e facieve **spilitike**, karakteristike kjo per ato derdhje efuzive qe bien ne kontakt te drejtë per drejtë me ujrat e detit te asaj kohe.

PROFIL 21 BREGEN

c. Ne tavanin e horizontit vullkanik te siper (horizonti i trete diabazik) shprehet qarte prania e elementeve te strukture fluidale e bajamore karakteristike kjo per koren me te siperme vullkanike.

Keto te dhena mendojme se na japin te drejten te nxjerim perfundimin se trupat vullkanike te Gjegjanit, jane ne pozicion normal (jo te permbysur) fakt ky i rendesishem per te hedh drite mbi strukturen e rajonit dhe per perspektiven e kerkimeve te mineraleve te bakrit ne te ardhmen.

Mbi xeheroret sulfuror dhe hekuror te vendburimit Gjegjan

a. Shtratimi bakermajtes i vendburimit te Gjegjanit (Fig.4,5,6,7,8), permbahet ne brendesi te pakos sedimentaro-vullkanogjene dhe zen vend kryesisht ne kontaktin e rreshpeve silicoro-hekuroro-argjilore te kuqe dhe diabazeve te horizontit te dyte. Trupi xeheror ka keto permasa: Ne shtrirje zgjatet 860 deri 900m. ndersa ne renie shkon 380 deri ne 400m. Trashesia e trupit verion nga 1 m e deri ne 25 dhe 30m. Shtrihet 40° ne VL-JP me kend renie $0-25-30^{\circ}$ ne drejtimin JL. Si rregull trupi xeheror vishet me nje kemishe silicoro-hematitike me pamje jashmore dhe trashesi nga 1-5m. Ne ekzokontakt verehet nje oreolle endogjene e perfaqesuar me pikezime, brezezime, njolla piriti dhe kalkopiriti me nje trashesi nga 0.5 deri ne 5m.

Perberja minerale e trupit xeheror (perberja mesatare) eshte si vijon: Pirit 40%, kalkopirit 10%, Mushketovit 6,8%, magnetit 0,3%, sfalerit 0,6%.


Perberja kimike mesatare eshte si vijon:

$Cu = 3.4\%$, $FeO = 36\%$, $S = 28\%$, $Zn = 0.66\%$, $Al_{2O_3} = 6.53\%$,
 $SiO_2 = 16.74\%$, $MgO = 1.8\%$, $CaO = 0.25\%$, $Co = 0.08\%$.

Forma e trupit xeheror eshte si te gjithe shkembejte e tjere te kcsaj serije ka karakter thijerzoro-shtresore, e cila shprehet edhe me ndryshime te theksuara ne trashesi (fryrje dhe hollime) Brenda trupit xeheror ka dhe raste kur takohen nderfutje shkembejsh sterile si: silicore, rreshpesh dhe diabazesh te ndryshuara qe jane ne pajtim me to. Ne trupin xeheror te bakrit, verehet nje fare zonaliteti hipogen-vertikal i kushtezuar nga predominimi ne anen e varur i xeheroreve sulfuroro-hematitik dhe hematitik, ndersa ne anen e shtruar i atyre vetem sulfuror (kalkopirit-pirit). Ne anen e varur zen vend gjithashtu edhe xeherori i hekurit ne formen e nje kapeleje mbi ate te bakrit. Xeherorii hekurit perbehet nga mineralet e hematitit, mushketovitit, magnetitit dhe limonitit. Ne plan kane formen e nje kapeleje me shtrirje nga 40 deri 100 m. dhe trashesi nga disa metro ne 15 m. Kane kete perberje mesatare kimike:

$Fe = 59.54\%$, $SiO_2 = 6.76\%$, $Cu = 0.16\%$, $S = 0.98\%$, $Na_{2O} = 0.17\%$,
 $K_{2O} = 0.18\%$.

Ne planin horizontal te trupit te bakrit, veme re nje fare zonaliteti mineralogjik, i cili shprehet ne drejtimin JL me mbizoterimin e xheronizimit sulfuror (te piritit dhe kalkopiritit) dhe me ulje te ndjeshme te oksideve te bekurit dhe sfalerrit dhe e kunderta ne drejtimin VP.

PREDMET KOGOLOGU - STRUKTURORĘGEGJENBARDONOCMORINELEGJENDA

- [Wavy line] Skalnaj ultrabazikai
- [Dashed line] Rrasiporā
- [Hatched pattern] Gelgerorē & Tg
- [Cross-hatch pattern] Amfibolite

- [Vertical line] Gelgerorē & Cr
- [Dotted line] Koncentriķu bazirabakts
- [Circle with cross] Vendi i priešķēs i tāpēc uzbars

Prania e kapeles se hekurit mbi shtratimin e xehleroreve te bakrit na lejon te nxerrim dy perfundime te rendesishme:

a. Mineralet e hekurit si minerale te rende, me pike shkrirje te ulet dhe aftesi te dobet levizeshmerie gjeokimike, si regull zene vend me afer grykes vullkanike duke na dhene keshtu ne dore nje element te rendesishem struktural.

b. Mineralet e hekurit si rregull formohen ne kushtet e nje ambienti fiziko-kimik oksidues, ne raport me mineralet e bakrit qe kerkojne nje ambient reduktues. Sipas Davidov L. K. dhe Konçina N. G. (Obshaja hidrogeologija, 1958) ambienti reduktues ne thellesite oqeanike duhet kerkuar mbi 2000m, ndersa ai oksidues ne thellesite 1500 deri 2000m. Formimi i ketyre dy lloje mineralesh (heku i bakri) ne thellesi te ndryshme nenujore tregon per levizje vertikale te fundit te oqeanit gjate kohes se aktivitetit vullkanik.

Mekanizmi i formimeve te mineraleteve te bakrit, pranohet si nje sedimentacion i koncentrimeve sulfurore ne gazrat vullkanike, te cilet sapo ndeshen me ujrat e oqeanit shndrohen ne hidroterma xehlerorbartese, te cilat shoqerohen dhe me depozitime radiolaritesh (silicoro-hematitike).

Duke vrojtuar me kujdes hartat e izotrasesive dhe te izopermbajtjeve (Fig.5,6) mund te nxerrim edhe disa perfundime te tjera te rendesishme:

a. Ne krahun VP, trupi xehleror sa vjen dhe hollohet deri ne trashesite 1-2-3m, ne raport me krahun JP, ku trashesia merr vlera te medha. Edhe ky fakt me sa duket na tregon se gryka vullkanike, nga ku kane buruar keto produkte, ka qene diku ne VP te vendburimit.

b. Forma e reliefit te dyshemesse se vjetet te trupit xehleror, sipas hertes perkatese, na ekspozon pranine e nje lugu, i cili mund te kete sherbyer si rruge per rrjedhjen e masave xehlerore te bakrit, drejtim ky qe fillimisht niset nga VP dhe pas nje kthese vazhdon per ne JL.

c. Nga harta e izopermbajtjeve konstatojme se cilesia e bakrit, per gjithesisht bie ne nivelet e ngritura te trupit dhe rritet ne nivelet e ulta. Ky fakt na len per te menduar se keto ndryshime cilesore ne vertikalitet, lidhen me nje fare diferencimi gravitativ te masave xehlerore sulfure, ne raport me ato jo sulfure.

Mbi shkembinje karbonatike tavanore te serise sedimentaro-vullkanogjene

Depozitimet karbonatike, si nje mbulese e formacionit sedimentaro-vullkanogjene, perfaqesohen kryesisht nga karbonate te kalciumit dhe me pak te kalciumit dhe magneziumit. Ne dukje paraqiten masiv, kompakt, me ngjyre te bardhe ne gri dhe shtrirje 30° deri 50° VL, me renie te variuveshme nga 20° ne 45° e deri 75° ne drejtimin e JL. Jane te facies neritike kryesisht stromatolitike, algore, te kristalizuar deri ne mermerizim dhe me nje ruajte te dobet te faunes dhe te flores. Te dhenat e shtrishmerise, flasin per nje fare perputhje te karbonateve me serine sedimentaro-vullkanogjene.

Mbulesa karbonatike e Koritnikut dhe e Gjallices se Lumes zhvillimin kryesor e merr ne lindje dhe juglindje te vendburimit te bakrit ne Gjegjan, forma fillestare e se ciles ka qene nje monoklinal, i cili me vone si rezultat i levizjeve tektonike u komplikua edhe me rrudha te rendeve te ndryshme, por qe gjithnjë e ruajne karakterin e tyre tavanor mbi serine sedimentaro-vullkanogjene.

3. Mbi marredheniet e pakos sedimentaro-vullkanogjene me shkembinjte rrethues

Si poshte-shtroje e pakos metamorfike sherbejne shkembinjte ultrabajke. Mendojme se marredheniet midis tyre jane intruzive (te nxehta):

a. Ne endokontakt vihet re nje bashkesi mineralesh tipike te facies talk-tremolit-klinoklor, e cila flet per nje metamorfizem regresiv, mbi shkembinjte ultrabajke, ne konditat e nje temperature qe varion nga 55° - 700° dhe te nje pH_2O nga 1000 deri ne 3000 bar (10).

b. Prania ne amfibolitet e ekzokontaktit e granatit te llojit spesartin deshmon per maredhenie te nje kontakti te nxehte. (10).

c. Prania ne endokontakt e hidrogranateve te imte te almandinit si dhe e aktinolitit si mineral epimimaginistik (i formuar nga bashkimi i mineraleteve te magneziumit ne peridotite dhe i aluminit ne shkembinjte sedimentare) jane me teper fakte qe flasin per kontakt te nxehte.

d. Ne amfibolitet here here vihet re nje linearitet i cili shprehet me forma te zgjatura te mineraleteve te muskovitit, kuarcit por jo te granateve. Ne disa kokriza te zhvilluara te granatit veme re edhe kaperthime grimcash te kuarcit dhe muskovitit, fakt tjeter ky qe deshmon se vete granati eshte mineral i me vonshem (epimagmatik), i lidhur me veprimtarine e erupsioneve ultabajke.

e. Per natyren paresore te shkembinjve metamorfike te zones se kontaktit flet edhe fakti se shkembinjte fillestare ne kete kontakt kane qene kryesisht mergeloret, per pranine e te cileve deshmon permbajtja e elementeve karakteristike si Be, Ga, Zr etj. Nga nje shpim i kryer kohet e fundit u kafen amfibolite me ndeshresa te holla mergelore, te cilat sipas mendimit tone Jane relikte te ish shtresave paresore te kontaktit qe i kane shpeshuar procesit metamorfik. Kjo eshte edhe nje aresye tjeter qe ne kete kontakt mungon andaluziti dhe kordieriti formimi i te cileve kushtezohet nga ekzistencia e nje magme qe kontakton me shtresat argjiloro-qymyrore, por jo mergelore.

Sipershtroja e pakos sedimentaro-vullkanogjene, perfaqesojet nga gelqeroret e Triasikut te siperin te malit Koritnik. Kontakti ndermjet ketyre shkembinjve per gjithesisht eshte tektonik, por ne sektore te veçante verehen kalime te doradoreshme nga pakoja vullkanogjene drejt shkembinjve karbonatike te tavanit. Ne fshatrat Gjegjan dhe Pobreg mbi serine sedimentaro-likuologjene ne maledhenie te doradoreshme ven losci gëfqueroret b: me trashesi nga 30m deri ne 100m e pamje kompakte te rrudhosur d: mikrorrudha dhe qe ngjashme me enanti me peraktuar ne ra tjetra te vendit toneku gjegje perhapje keto lloje shkembinjsh.



Fig. 4 PLANI I DIXHENGJESË TREPAT KONGAOR
~~~~~ DREZNAKI, ARRIJONJE VULLKANIKE




Fig. 5 HARTA E ISOTRAGHESEVE (MORFONOVO)  
PO TREPAT KONGAOR Gjegjia.




Fig. 7  
[Legend:  
1. KALDË KARST  
2. DRUPE TE KUQE  
3. VULLKANI KONGAOR  
4. TREPAT KONGAOR TE DIXHENGJUE  
5. VULLKANI KONGAOR BIASH]




Fig. 6 HARTA E ISOTRAGHESEVE  
TREPAT KONGAOR GJEGJEN

Ne disa shpime te kryera keto kohet e fundit jane kapur maredhenie normale te doradoreshme nga seria drejt gelqeroreve tavanore. Nisur nga keto te dhena mendojme se keto maredhenie midis serise dhe shkembinje karbonatike, fillimisht kane qene normale, me kalime te doradoreshme por qe me vone keto marredhenie u shndruan ne tektonike, si rjedhoje e forcave shtytese te ardhura nga lindja, te cilat te favorizuara edhe nga reliivi u shoqeruan edhe me tektoniken rreshqitese-gravitative, e cila vuri ne levizje masa gelqeroresh qe te rreshqasin mbi shkembinje plastike te serise sedimentaro-vullkanogjene. Si efekt i kompleksitetit te ketyre levizjeve tektonike, rrreth 2km ne drejtimin gjeresor, larg buzes se kontaktit te gelqeroreve me serine, shfaqen çarje tektonike gjatesore, nepermjet te cilave kane levize drejt lartesive copra dhe bloqe shkembinjsh ultrabazike dhe rreshpor te cilat ne i gjejme edhe sot brenda fushave te shkembinje karbonatike.

#### 4. Mbi strukturen e rajonit

Nga te dhenat e mbledhura deri tani, qofte ne fushen gjeologjike, litologjike, tektonike, mineralogjike, petrografike, mikrofaunistike etj. perforcohet mendimi se struktura e rajonit per rrreth vendburimit te mineraleve te bakrit ne Gjegjan, eshte ne nje pozicion normal, fakt ky qe duhet te sherbeje edhe si baze per te orientuar vemendjen ne kerkimin e shesheve te reja bakermbajtese.

Struktura e rajonit na shfaqet ne formen e nje monoklinali me shtrirje VL-JP (azimut renie  $130^\circ$ ), i cili ne hapesiren juglindore te vendburimit, komplikoket ine rrudha dhe prishje tektonike te karakterit dizjuktiv. Ne kete kuader elementi me i rendesishem struktural i percaktuar eshte aksi i vendburimit te Gjegjanit i cili shtrihet me  $45^\circ$  VL dhe me kend renie nga  $25^\circ$  ne  $65^\circ$  ne JL.

Ideja e nje strukture te tille, ne te cilen pakoja sedimentaro-vullkanogjene ka si poshteshtroje shkembinje ultrabazike dhe si sipershtroje gelqeroret e Koritnikut, mendojme se argumentohet nga faktet e me poshteme:

a. Nga prania e nje shishtezimi karakteristik te serpentiniteve si poshteshtroje e pakos sedimentaro-vullkanogjene dhe perputhja e plote e elementeve te shtrishmerise ndermjet tyre.

b. Menyra e kontaktit intruziv midis shkembinje ultrabazike dhe pakos rreshpore, eshte nje tjeter fakt i rendesishem.

c. Nga prania e nje zonaliteti petrografik dhe mineralogjik si ne planin vertikal ashtu edhe ne ate horizontal i shprehur qarte ne trupin xeheror te bakrit dhe ne te tre horizontet kryesore te trupave vulkanike diabazike te prerjes se Gjegjanit, zonalitet i cili deshmon per pozicionin normal te struktureve te rajonit.

d. Nga prania e nje horizonti karakteristik te gelqeroreve nyiore te kuqerremte, i cili eshte fiksuar ne Lojme dhe qe eshte ndjekur me shkeputje deri ne Gjegjan dhe Morine dhe qe perben nje horizont reper te moshes triasik




Fig. 6 SKEMA PLANIMETRIKE E TRUPIT XEHEROR  
ME ELEMENTET KRYESORE STRUKTURAL! *Gjegjen*



TROPI XEHEROR I BACRIT

NOISHTROJE HEKURORE

AKS I STRUKTURES PARAGORE TE VENABURIMIT

OREJTEGET E RRJEGORIJEVE VOLKANIKE TE ALASAVE XEHERORE.

i mesem-siperim, nepermjet te cilit kalohet nga pakoja sedimentaro-vullkanogjene ne gelqeroret tavanore masive, te cilet duhet ti perkasin triasikut te siperim deri ne juren e poshtme.

e. Nga prania e nje pakoje kalimtare gelqeroresh mergelore ose mergelesh me shtresezim te holle, ndermjet pakos metamorfike dhe gelqeroreve masiv tavanor.

f. Nga prania e produkteve te alterimit te shkembinjve ultrabazike, ne perberjen e mases karbonatike te gelqeroreve tavanore te kesaj pakoje (grimca serpentiniti, bastiti, kloriti, kromiti, magnetiti etj.) si dhe grimca te pakos metamorfike rreshpore (kuarc, silicore, sericit, klorit, pirit, albit, granat etj.).

g. Duke marre si pike referimi vendburimin e Gjegjanit, rrreth 2km me ne lindje te tij, eshte fiksuar prishja e madhe tektonike e Zbinecit, e cila ka nxjerr ne drite jo vetem copra por edhe bloqe e deri ne masive te vegjel shkembinjsh ultrabazike si dhe fragmente te pakos rrshpore, ç'ka deshmon per vazhdimesine drejt lindjes te pakos metamorfike rreshpore dhe nen te te shkembinjve ultrabazike. Prania gjithashtu ne produktet e kesaj prishjeje dhe e mallahitit flet edhe per mundesine e pranise ne hapesirat e kesaj prishjeje edhe te ndonje cope ose bloku kalkopiriti, te shkeputur nga thellesia e pakos rreshpore dhe te ngjitur ne lartesite e reliefit nga levizjet tektonike, fakt tjeter ky qe tregon jo vetem per vazhdimesine normale te strukturae drejt lindjes por edhe per bakermajtjen e saj.

## LITERATURA

**Çako Q., Vllaho J. etj. 1962** - Raport paraprak mbi rezultatet e punimeve gjeologjike te kerkim-zbulimit ne shk. 1:10.000 dhe te zbulimit te vendburimit te bakri, ne Gjegjan. Fondi qendor.

**Çili P. 1966** - Koha e formimit dhe vendi ne hapesire i shkembinjve efuzive. Permbledhje Studimesh, Nr.3.

**Geskell T.F. 1963** - Pod gllubinami okeanov. Moskva.

**Grazhdani A. 1987** - Metalogjenia e thyerjeve terthore te Albanideve. Bul. Shk.Gjeol. Nr.4

**Gjata Th. etj. 1987** - Stratigrafia e depozitimeve triasike dhe kushtet e formimit te depozitimeve triasike ne albanidet lindore. Bul. Shk.Gjeol. Nr.2.

**Instituti i Kerkimeve dhe i Studimeve Gjeologjike.** Nderm. Gjeol. Kukes dhe Rubik. Mbi punimet kerkimore tematike "Vleresimi i perspektives per xehore te pasur sulfid te bakrit ne formacionin efuzivo-sedimentar te brezit Morine-Selishte. Fondi qendor, 1968.

**Kodra A. 1976** - Mbi moshen jurasike te formacionit vullkanogjeno-sedimentar te zones Mirdita. Permb.Stud. Nr.1.

**Kodra A., Gjata K. 1982-** Ofiolitet ne kuadrin e zhvillimit gjeotektonik te albanideve te brendeshme. Bul.Shk.Gjeol. Nr.2 .

- Kodra A.** - 1986 - Gjeologjia dhe perspektiva e mineraleve te dobishme ne rajonin Resk-Shishtavec. Disertacion.
- Noka H.** 1975 - Rreth problemit te maredhenieve te kontaktit ndermjet shkembinjve ultrabajke dhe formimeve efuzivo-sedimentare te triasikut te poshtem e te mesem ne sektorin e Qinemakes (Kukes) Permb.Stud. Nr.2
- Shallo M.** 1965 - Mbi marredheniet e kontaktit midis shkembinjve ultrabajke te Kukesit dhe formimeve efuzivo-sedimentare te triasikut te poshtem-te mesem te rajonit te Surrojt. Permb.Stud. Nr.1.
- Shallo M.** 1971 - Ndertimi gjeologjik i mineraleve te dobishme te rajonit te Korabit. Fondi qendror.
- Shima G.** 1978 - Disa te dhena mbi ndertimin gjeologo-tektonik te rajonit te Klenjes. Permb.Stud. Nr.1.
- Rithman A.** 1964 - Vulkani i ih dejatelnost. Izdatelstvo Mir. Moskva.

## S U M M A R Y

### THE VOLCANO-SEDIMENTARY FORMATION OF KUKES (NORTH-EASTERN ALBANIA)

The problem of the relations of the volcano-sedimentary formation with the surrounding rocks, its structure and copper-bearing perspective are provided here.

The relation of the volcano-sedimentary formations with the rocks of the lower part (ultrabasic one) are intrusive.

The lack of the cordierite and andalusite are linked with missing of the clayey-coal facies at the contact zone.

This formation has a folded monocline structure with S-E development, with the ultrabasic rocks at the bottom and the Upper Triassic limestones on the top.

The spatial position of this structure is normal.

Two new copper mineralization prospecting squares have been determined based on the lithological-structural data and other factors.

The limestones, as a topmost part of the volcano-sedimentary formation preserve the normal continuity at some sectors: from the clay-chert schists to marly ones and, finally, to the massive limestones.

The serpentinite, chromite, pyroxenite etc. grains occur in these limestones. This fact speaks for an older age of the ultrabasic rocks in respect to the limestones.

## LIST OF CAPTIONS:

- Fig.1 - Geological structural sketch map of Morine-Gjegjan-Perbreg.
- Fig.2 - Geological-structural section of Gjegjan (profile 21)
- Fig.3 - Geological-structural section of Gjegjan-Bardhoc-Morine
- Fig.4 - The bottom of the ore body (Gjegjan ore deposit)
- Fig.5 - The map of isocontent ( Gjegjan ore body)
- Fig.6 - The map of the isothicknesses (isopachytes) of ore body of Gjegjan deposit.
- Fig.7 - The sketch of the ore body.
- Fig.8 - The map scheme of ore body Gjegjan.

### Legend of geological-structural section Nr.21

1. Ultrabasic rocks
2. Amphibolites
3. Schists
4. Diabase
5. Reddish schists
6. Copper ore body
7. Marly limestones.
8. Limestones of Upper Triassic.

# MINERALIZIMET E BAKRIT QE LIDHEN ME OFIOLITET SHQIPETARE (COPPER SULPHIDE MINERALISATIONS RELATED TO VOLCANITES OF ALBANIAN OPHIOLITES)

**IBRAHIM MILUSHI, VEHAP BÉZHANI**

Institute of Geological Researches Tirana, Albania

## H y r j e

Vendburimet me te rendesishme te bakrit ne Shqiperi lidhen me vullkanitet qe perhapen ne pjeset qendrore te ofioliteve te zones Mirdita (Fig.1). Mbi 80% e potencialit ~~bakermajtës~~ te ofioliteve shqiptare i perket brezit te vullkaniteve Qafe-Mali-Perlat me gjatesi rrerë 40km dhe gjeresi jo me shume se 4-5km. Per me shume se 35 vjet ky brez, si dhe vullkanitet e ofioliteve ne teresi, u jane nenshtruar punimeve intensive te kerkim-zbulimit, si rezultat i te cilave eshte bere i mundur evidentimi i qindra shfaqjeve te mineralizuar dhe i nje numri te konsiderueshem vendburimesh te vogla, te mesme e te medha, me sasira nga disa dhjetra mijra ton deri 12 miljon ton rezerva xeherori me permbajtje bakri deri 5%, piriti deri 35-40%, zingu deri 2-3% e ne disa raste me permbajtje teper interesante te Au, Ag.

Rreth 3 miljon ml shpime dhe disa mijra ml galeri jane kryer per kerkim-zbulimin e Cu qe lidhet me vullkanitet e ofioliteve. Per me se 25 vjet jane shfrytezuar sasira te konsiderueshme rezervash duke arritur te shfrytezohen gjate viteve 80-te deri 1 miljon ton rezerva brenda nje viti.

Si rezultat i aktivitetit te madh gjeologo-minerar eshte bere e mundur te dalin ne pah aspekte te rendesishme lidhur me maredheniet e mineralizimit me shkembinje rrethues, morfolojjine e trupave xeherore, perberjen minerale dhe elementare te tyre etj. Ne kete artikull do te perpiqemi te permbledhim disa prej ketyre aspekteve.

## Kuadri Gjeologjik

Kompleksi ofiolitik shqiptar me moshe Jurasic i mesem, i sipërme okupon rrerë 4300 km<sup>2</sup> ose afro nje te shtaten e gjithe territorit te Shqiperise. Ai se bashku me periferine karbonatike dhe formacionin vullkano-sedimentar nderton zonen Mirdita, e cila ne jug vazhdon me zonen subpelagoniane te Helenideve, kurse ne veri me zonen Serbe te Dinarideve. Ky kompleks perfqajesohet nga dalje te fuqishme te shkembinje ultrabajke, grove, trondjemiteve, plagiograniteve, kompleksit te dajkave paralele dhe skuencave vullkanike te perfqajesuara nga bazaltet, andezito-bazaltet, andezitet, dacitet, riocacitet etj.




Fig. 1. KOMPLEksi OFIOLITIK NE SHQIPERI.  
OPHIOLITIC COMPLEX IN ALBANIA.

1-Depozitimi molosile të Nogçitit (Aero/geoformations of Neogene age); 2- Gëlcënë e pëllazheve liqenore me C. facies (C. facies limestone); 3- Karbonate triasiko-jurasic (carbonates of Triassic-Jurassic age); 4- Karbonate triasiko-jurasic (thin-layered limestone intercalated with cherts); 5- Karbonate triasiko-jurasic (C. calcareous-sedimentary formation of Triassic-Jurassic age); 6- Shkatim i këmbëzve (Probasal rocks); 7- Vulkanite (volcanic) i.e. mafik (i.e. mafic volcanic); 8- Vulkanite me afimet te oqurosubokselorit (andesite-basaltic), andesite, dacite other mafic rhyolitic (i.e. leucites of suprasubokselor affinity andesite-basaltic, andesite, dacite and rhyolite rhyolitic); 9 - Plagiograni (Plagiogranite); 10- Gëlcënë e pëllazheve (C. facies in limestone).

Prej vitesh nga studjes te ndryshem (Ndojaj I., 1962; Dede S., 1965; Gjata K., 1970; Tashko A., 1976; Shallo M., 1980; Turku I., 1981; Bazhani V. etj., 1980 etj.) jane vene ne evidence dallime te rendesishme petrologjike, sekuenciale, metalogjenike e strukturore ndermjet krahut lindor dhe atij perendimor te ofioliteve.

Ndonese, pothuajse nga te gjithe studjesit e viteve te fundit nuk ekziston dyshim per unitetin e formimit te ofioliteve, por per te shpjeguar ndryshimet e verejtura mekanizmi i formimit, ka qene dhe vazhdon te jetë objekt i rendesishem diskutimi.

Autore te ndryshem (Shallo M. etj., 1980, 1985; Harta Gjeologjike e Shqiperise, 1983 etj.; Grup autoresh, 1989 etj.) kane ndertuar profile gjeologo-metalogjenike te veçanta per krahun lindor e ate perendimor dhe eshte bere i modes perdonimi i termave "brezi lindor" dhe "brezi perendimor" i ofioliteve shqiptare. Nderkohe, deri tani nuk eshte bere e mundur heqja e nje kufiri ndermjet ketyre "dy brezave", e aq me teper nuk eshte svaruar akoma ekzistenza ose jo e ndonje reperi litologjik ose strukturor. Pavaresisht nga pikepyetjet lidhur me kufirin dhe mekanizmin e formimit, ndermjet ketyre te ashtuquajturave "breza" ekzistojne dallime te rendesishme.

Keshtu, pjesa perendimore, i ashtuquajturi "brezi perendimor" i ofioliteve shfaq nje karakter te permbajtjes te larte te titanit, ashtu sikurse edhe ato te sistemit Alpin-Apenin dhe krahasohen mjaft qarte me sekuencat magmatike qe gjenerohen ne kurzoren mesoceanike (MORB).

Pjesa lindore, i ashtuquajturi "brezi lindor" i ofioliteve zakonisht reflekton karakteristika te permbajtjes se ulet dhe me rralle shume te ulet titanit (borinit) qe krahasohen qarte me sistemet magmatike te suprasubduksionit intraoceanik ashtu sikurse shumica e ofioliteve nga brezi i Tetisit lindor (Vurinos, Trodos, Tauride, Iran, Oman etj.).

Te ashtuquajturit breza ofiolitike, karakterizohen nga diferenca ne radhen e kristalizimit te mineraleve kryesor paresor, dhe po ashtu nga trende te ndryshme te fraksionimit qofte per prerjet ekstruzive ashtu edhe per ato intruzive (Beccaluva etj., 1992). Por, verehen edhe shmangje aktualisht ende te pa shpjeguara nga ky rregull.

Perveç magmave bazike paresore, edhe tektonitet mantelore Jane gjithashtu dukshem te ndryshme, duke qene kryesisht lercolite ne pjesen perendimore dhe harzburgite ne pjesen lindore. Dallimet jane te rendesishme edhe ne pikpamje metalogjenike. Keshtu, vendburime te rendesishme kromitesh te tipit metallurgjik jane zbuluar ne te ashtuquajturin brezi lindor ultramafik, kurse ne te ashtuquajturin brezi perendimor ultramafik jane zbuluar vetem nje sasi e vogel shfaqjesh kromitike, kryesisht te tipit refraktar.

Afersisht e njejtë panorame verehet edhe per sekuencat vulkanike. Nderkohe qe me vulkanitet me afinitet te suprasubduksionit, qe zene pjesen lindore te fusheperhapjes vulkanike, te cilat perbehen nga andezito-bazalte, andezite, dacite, riolite etj., lidhen vendburime te rendesishme te bakrit sulfur, qe ne disa raste kane karakter polimetalik, me vulkanitet me afinitet MORB

qe zene pjesen perendimore e qe perfaqesohen nga bazalte me permajtje te larte titani, lidhen vendburime te rralla e me nje mineralogji te thjeshte.

### **Vullkanizmi i kompleksit ofiolitik, mbajtes i mineralizimeve sulfure te bakrit dhe piritit**

Sekuencat vullkanike te kompleksit ofiolitik okupojne reth  $620 \text{ km}^2$ . Rreth  $590 \text{ km}^2$  i takojne gjysmes veriore te ofioliteve ne veri te Korridorit te Shengjergjit dhe vetem  $30 \text{ km}^2$  perhapen ne gjysmen jugore.

Ky vullkanizem karakterizohet nga nje zhvillim i fuqishem dhe i larmishem i facieve me afinitet MORB, dhe i atyre me afinitet te suprasubduksionit.

Autore te ndryshem (Bezhani V. etj., 1980; Turku I., 1981; Shallo M., 1981; Shallo M. etj., 1989 etj.) kane vene ne dukje ndertimin kompleks te ketyre vullkaniteve, dallimet ndermjet sektorit verior e atij jugor, si dhe ndryshimet e rendesishme qe vihen re ne sektorin verior ne prerjen e vullkaniteve nga perendimi ne drejtum te lindjes.

Ndryshimet ndermjet sektorit verior dhe atij jugor shprehen jo vetem ne intensitetin e vullkanizmit por edhe ne perfaqesimin facial. Keshtu, nderkohe qe ne sektorin verior kemi nje zhvillim shume te fuqishem te vullkanizmit bazik dhe mesataro-acid me afinitet MORB dhe te suprasubduksionit dhe nje zhvillim relativisht te fuqishem te kompleksit te dajkave paralele, ne sektorin jugor intensiteti i vullkanizmit eshte i dobet dhe perfaqesohet vetem nga vullkanizem bazaltik tip MORB, e nderkohe kompleksi i dajkave paralele mungon. Keto ndryshime shprehen edhe ne sekuencat plutonike. Ndersa ne sektorin verior kemi zhvillir te fuqishem te sekuencave gabrore e plagiogranitike, si dhe intruzione te vegjel dhe dajka te ketyre shkembinjve qe arrijne deri ne majen e prerjes vullkanike, ne sektorin jugor zhvillohen vetem sekuencia gabrore me perhapje te kufizuar.

Vullkanitet e sektorit jugor jane te ngashme me krahun perendimor te fushoperkapse vullkanike te sektorit verior dhe me vullkanitet e formacionit vulkan-sedimentar ne periferi te ofioliteve.

### **Profili i mineralizimit te bakrit sulfur**

Po aq komplekse dhe e nderlikuar sa ç'eshte prera e sekuencave plutoniko-vullkanike te kompleksit ofiolitik eshte edhe prera e mineralizimit sulfur qe lidhet me keto sekuencia.

Evolucioni i mendimit shkencor per pozicionin e lokalizimit te xherorit, gjenezen, mardheniet e tije me shkembinje rrethues etj ka njojur shpesh mjaft debate te fuqishme.

Prera plutoniko-vullkanike e kompleksit ofiolitik karakterizohet nga nje zhvillim shume i fuqishem i proceseve mineralformuese. Keto zhvillime reflektohen ne ngopshmerine mjaft te larte te kesaj prera ne mineralizime

Fig. 2

Kolona gjeologjike e Mirdites Qendrore. (Geologic -metallogenetic column of the Central Mirdita).

- 1.Dacite dhe rioda -cite.(Dacite, rhyodacite); 2.Andezite(Andesite); 3.Andezito - bazalte (Andesite - basalts); 4.Bazalte me permabajtje te larte titani. (High-Ti basalts); 5.Kompleksi i dajkave parallele: a. te spredingut, b.te kombinuara. (Sheeted dyke complex); 6.Plagiogranite (Plagiogranite); 7.Gabro (Gabbro); 8.Trupa xehore bakri. (Copper ore bodies)





Fig. 3

Harta gjeologjike dhe shfaqjet e minera-lizuara te bakrit ne rajonin Qafe Mali-Spac. (Geological map and copper mineralizations of Qafe Mali-Spaçi region)

- 1.Formacioni sedimentar i Kretakut te poshtem. (Lower Cretaceous sedimentary formation); 2.Pako argililit me copa. (Argillic clastic pack) 3.Bazalte me permabajtje te larte titani. (High-Ti basalts); 4.Andezitobazalte, andezite. (Anesite-basalts, andesite); 5.Dacide-riodacide.(Dacite and rhyodacite); 6.Kompleksi i dajkave parallele. (Sheeted dykecomplex); 7.Dajka terthore bazaltike. (Transversal basaltic dykes); 8.Gabro. (Gabbro); 9. Serpentinite. (Serpentinit); 10. Shfaqje te mineralizuara bakri. (Copper mineralizations outcrops).

sulfure bakri, piriti etj. (Fig.2,3) dhe ne numrin e madh te vendburimeve te zbuluara. Ky mineralizim perqendrohet ne vlera industriale ne te gjithe prerjen plutoniko-vullkanike, por prerja e krahut lindor te fusheperhapjes vullkanike karakterizohet nga perqendrime teper te rendesishme ku spikat struktura Q-Mali-Perlat (Fig.3).

Mineralizimi i bakrit qe lidhet me sekuencat gabrore, plagiogranitet dbe me kompleksin e dajkave paralele ka natyre nderprerese, ndersa mineralizimi i bakrit qe lidhet me sekuencat vullkanike perveç natyras nderprerese shpesh takohet edhe ne trajta pajtuese me shkembijnje rrethues duke u perqendruar kryesisht ne kufijte ndermjet sekuencave te ndryshme. Mineralizimi pajtues eshte me i rendesishmi dhe vendburimet me te njojhura (Paluca, Q.Bari, Munella, Gurthi, Spaci, Perlati etj.) i perkasin ketij tipi. Mineralizimi sulfur i bakrit qe lokalizohet ne prerjen plutoniko-vullkanike, mendohet te jete i lidhur gjenetikisht me kete prerje dhe perfaqeson fazë evolutive qe prekin nivele te ndryshme te prerjes, e ne mjaft raste keto faza mbivendosen duke sjelle komplikacione te rendesishme.

Qarkullimi i rrymave konvektive te ujtit te detit nepermjet sistemeve te çarjeve dhe tektonikave sinformuese ne Koren Oqeanike te nxehet eshte perjegjes per fornimin e ketyre vendburimeve. Nje qarkullim i tille pershon sekuencat vullkanike, kompleksin e dajkave paralele dhe pjeset e siperme te prerjes plutonike te perfaquesuar nga gabrot e plagiogranitet (Best, 1982). Si rezultat i qarkullimit te ketyre ujrate te nxehta realizohet nxjerrja e lendet xeherore e cila ne trajte kriprash te ndryshme qarkullon ne drejtim te siperfaqes. Nje pjese e lendet xeherore depozitohet neper çarjet dhe sistemet tektonike sinformuese gjate gjithe prerjes plutoniko-vullkanike, duke formuar mineralizimet shtokverkore e pikzimore, ndersa pjese te rendesishme derdhen ne "basene" per te dhene mineralizime pajtuese e shpesh me elemente te qarte te sedimentimit. Nje situate e tille vrojtohet qarte ne prerjen e mineralizimit sulfur te bakrit e piritit ne ofiolitet e zones Mirdita. Keshtu mineralizimet qe lidhen me gabro-plagiogranitet (Kurbneshi, Thirra, Tuçi Lindor etj.), mineralizimet qe lidhen me kompleksin e dajkave paralele dhe ato te niveleve te poshtme te vullkaniteve perfaqesojne tipin nderpreres, shtokverkor, damaror e pikzimor, ndersa trupat masiv ne L.Roshi, Q.Bari, Munelle, Gurth etj. perfaqesojne "derdhje" pajtuese me elemente te sedimentimit.

### **Disa karakteristika te mineralizimit te bakrit sulfur qe lidhet me vullkanitet**

Mineralizimet e bakrit sulfur qe lidhen me vullkanitet e perfaquesuara nga bazalte tip MORB (Kaçinari, Fushe Artesi, Rehova etj.) perfaqesohen nga trupa shtokverkor thjerzoro-pseudoshtresor dhe paraqiten ne trajta pikzimore deri masive. Karakterizohen nga nje mineralogji e thjeshte kryesisht pirit-kalkopirit, me vlera te ulta sfaleriti e me permbajtje mjaft te ulta te Au e permbajtje relativisht te larta te Co. Keto mineralizime ne baze te perberjes se thjeshte mineralete, te permbajtjes se ulte te Au dhe permbajtjes se larte te Co

Njësione shume me mineralizimet e bakrit qe lidhen me kompleksin vulkano-sedimentar ne periferi te ofioliteve. Mineralizimet e bakrit qe lidhen me vullkanitet me afinitet te suprasubduksionit (Paluce, Lak Roshi, Qafe Bari, Munelle, Gurth Spaç, Spaç, Perlat etj.) karakterizohen nga trupa me morfologji mjaft te larmishme e ne rastet me te per gjitheshme me trajta te shrregullta shtokverkore, thjerzore, pseudoshtresore etj. Ne per gjithesi zoteron mineralizimi ne trajte zonash te fuqishme pikzimore, brenda te cilave takohen perqendrime masive zakonisht ne trajta te shrregullta (Fig.4), por takohen edhe trupa masive me kontakte thuajse te prere (Fig.5) ose qe rrrethohen nga zona te dopta minerale pikzimore qe nuk i kalojne disa metra (Q.Bari etj.).

Vendburimet me te rendesishme jane pajtuese dhe lokalizohen ne kontaktin midis sekuencave te ndryshme. Keshtu, vendburimet masive te Lak Roshit, Gurth Spaçit, Paluces etj. lokalizohen ne kontaktin ndermjet andezito-bazalteve dhe andeziteve. Vendburimi i Qaf Barit lokalizohet ne kontaktin ndermjet andezito-bazalteve dhe riodaciteve, kurse vendburimi Munelle ne kontaktin e andezito-daciteve dhe riodaciteve.

**2.2- Faciet dunitike.** Kjo facie eshte e zhvilluar mire ne masiv. Ne per gjithesi dunitet jane te serpentinizuara, vende-vende takohen dunitet e fresketa qe paraqiten ne forme "pullash" ne dunitet e serpentinizuara. Olivinat e duniteve te serpentinizuara jane te tipit  $Fo_{91}$ ; mikrostrukturat jane te tipit granoplastike izometrike, dhe rralle granoplastike tabulare kokerr medha. Ne dunitet e freskta olivinat jane te tipit  $Fo_{90}-Fo_{92}$ , mikrostrukturat jane porfirolastike mesatarisht te rikristalizuara, rralle ato jane porfirolastike me nje fillim te rikristalizimit dinamik (kamp. n°44 dhe 45, Fig.2). Duke u mbeshtetur ne nenstrukturat e takuara ne olivinat, mund te thuhet qe kjo facie i eshte nenshtuar nje deformimi te temperaturave te larta (Nicolas & Poirie, 1976, 1979, Raleig & Kirby, 1970., Nicolas etj., 1981). Perberjet kimike te olivinave te analizuara ne mikrosonden elektronike, dhe mikrostrukturat e takuara, tregojne qe dunitet e freskta korespondojne me nje tektonit te vertete.



**Fig.6. Histogramat ne facien harzburgit-dunite.**

A - Olivinat; B - Piroksenit; C - Spineli.

**2.3- Facia e klinopiroksenit me olivin. Kjo facie eshte shume pak e perhapur ne masiv dhe takohen vetem ne pjeset me te siperme te prerjes gjeologjike. Klinopirokseni eshte i tipit Wo<sub>48.92</sub> (tab.n°1, kamp. n°36, Fig.2); orthopirokseni eshte i tipit En<sub>79.37</sub>. Pra duket qarte qe perberja kimike e enstatitit te kesaj facie nuk eshte e njeje me ate te facies harzburgitike. Kjo tregon qe duke kaluar drejt pjeses se siperme te prerjes, ka nje evolucion kriptik qe eshte i lidhur me nje kristalizim te fraksionuar qe zhvillohet ne dhomen magmatike. Nga pikpamja mikrostrukturale kjo facie zoteron nje mikrostrukturre si granoblastike po ashtu dhe porfiroklastike mesatarisht te rikristalizuar.**

**2.4- Facia e vebsteritit me olivine. Vebsteritet me olivine jane shume pakte zhvilluara ne masiv. Ato takohen kryesisht ne zonen kalimtare midis duniteve dhe gabrove. Klinopiroxeni eshte minerali me i perhapur dhe sasia e tij ne shkemb ndryshon nga 13% deri ne 54%. Ortopiroxeni perben 13% deri ne 60% te shkembit, olivinat perbejne 8% deri 34,5% te shkembit. Ne kete facie dallohen dy tipe te mikrostrukturave: mikrostruktura porfiroklastike, kokerr madhe, shume pak e rikristalizuar dhe mikrostruktura granoplastike izome-trike. Gjurma e deformimit te takuara ne olivinat flasin per nje deformim me teper te temperaturave te ulta.**




Fig.7. Histogramat per facien dunitike.

A - Olivinat; B - Spineli.

**2.5- Facia vehrlitike.** Vehrilitet shprehen mire sidomos ne pjesen veriperendimore te masivit (Fig.2.1). Olivina eshte minerali me i perhapur qe perben deri 85.23% te shkembit. Klinopirokseni perben nga 9% deri ne 17%, i tipit  $Wo_{48.88}$  (Tab. n° 1, kamp. n° 41, Fig.2). Orthopirokseni perben nga 0,5% deri ne 4% te shkembit. Ai eshte i tipit  $En_{50.24}$ . Mikrostrukturat jane te dy tipeve: granoplastike izometrike kokermesme deri kokerrmadhe dhe porfiroklastike. Duke u mbeshtetur ne gjurmet e deformimeve verehet qarte mbivendosja e dy tipeve te deformimit.

**2.6- Facia lehrcolitike.** Lehrzolitet zhvillohen kryesisht ne pjesen veriperendimore te masivit ne kontaktin me gabro-noritet (Fig.1,2). Sasia e ortopiroksenit nga nje kampion ne tjetrin eshte shume e ndryshueshme; ajo ze nga 6 deri ne 17% te shkembit. Sasia e klinopiroksenit ndryshon nga 33% deri ne 43,5% kurse olivinat perbejne nga 43 deri 54% te shkembit. Mikrostrukturat qe takohen jane: granoplastike izometrike, granoplastike tabulare dhe porfiroklastike pak e rikristalizuar.

**2.7- Gabro dhe gabro-noritet.** Gabrot dhe gabro-noritet perbejne pjesen e siperme te masivit dhe perhaqen kryesisht ne veri dhe ne perendim te masivit. Nganjehere ato takohen brenda thijerezave te pirokseniteve te izoluara ne dunitet. Plageoklazi eshte i tipit  $An_{94}-An_{95}$ , klinopirokseni eshte i tipit  $W_{71}$ , orthopirokseni eshte  $En_{63}$  (Tab. n°1, kamp.n°39, Fig.2) dhe  $En_{71,40}$  (kamp.n°40, Tab. n°1, Fig.2).

Mikrostrukturat korespondojne me ate te nje kumulati te deformimit ne gjendje plastike. Te dhenat kimike te olivinave (Tab.n°1, Fig.2) tregojne qe duke kaluar nga nivelet me te poshteme (harzburgitet dhe dunitet) ne drejtim te niveleve me te siperme (piroksenet te zones kalimtare dhe gabrot), olivinat behen me te pasura ne hekur dhe me te varfera ne magnez. Te dhenat mikrostrukturale tregojne qe intensiteti i deformimit te facieve te ndryshme petrografike eshte i dobet. Duke patur parasysh ciklin e deformimit (Boullier, 1977), vihet re qe ky cikel per formacionet shkembore te masivit ndalet ne nivelin e mikrostrukturave porfiroklastike mesatarisht te rikristalizuara.

### 3. Deformimi ne shkembinjte ultramafik te masivit

Perdorimi i mikrostrukturave dhe i intensitetit te rikristalizimit; per te vene ne dukje zhvillimin cilesore te deformimit te facieve te ndryshme te masivit eshte i veshtere per shkak te serpentinizimit. Duke perdorur zgjatjen e kristaleve te mineraleve te ndryshme te matura sistematikisht ne faciet e ndryshme, ne do te mundohemi te percaktojme nga njera ane menyren e ndryshimit te deformimit nga nje facie ne tjetren dhe nga ana tjeter natyren e ketij deformimi brenda te tjejtës facie.

**3.1- Deformimi ne harzburgitet.** Studimi i zgjatjes dhe i madhesise se kristaleve ne kete facie eshte bere mbi olivinat, piroksenet dhe kromitin akcesor. Matjet jane realizuar ne planin "XZ", plan qe eshte pingul me planin e shtrirjes (Nicolas etj., 1971, Nikolas dhe Boudier, 1975, Darot et Boudier, 1975). Gjatesia (L) e kokrrizave eshte matur sipas drejtimit "X" kurse gjereria (1) sipas "z". Ne te gjitha rastet, zgjatja e kristaleve jepet si raport i aksit te madhe mbi aksin e vogel (L/1) kurse madhesia e kokrrizave jepet si shuma e aksit te madh me aksin e vogel e pjestuar me dy (L+1)/2. Ne rastin kur kokrrizat nuk jane te zgjatura paralel me gjurmen e planit te shtrirjes, kjo madhesi mund te shprehet nga nje raport L/1 me te vogel se 1. Vlerat mesatare te fituara per te gjitha mineralet e studjuara per kete facie jepen ne Tab.n°2. Shperndarja ne hapesire e vlerave te zgjatjes dhe te madhesise se kokrrizave jepen respektivisht ne Fig. 2,3. Per olivinat zgjatja e kristaleve ndryshon nga 2 deri ne 2,3 per piroksenet nga 1.9 deri ne 3 dhe per spinelin kron. fer nga 1.8 deri ne 3. Ne disa raste zgjatja e kristaleve te spinelit mund te arrije deri ne 12 (Fig.5C). Histogramat e vlerave te matjeve si per madhesine e kokrrizave dhe per zgjatjen e kristaleve jane nje modale (Fig.5).

Per olivinat, ndryshimi i perqindjes se zgjatjes se kristaleve te regjistruara si brenda nje shlfis ashtu dhe ne gjithe facien tregon qe kristalet e olivines nuk jane te gjithe te njekohshem, si rrjedhim mund te mos kene te gjithe te njejten origjine. Mund te mos perjashtohet fakti qe ndryshimet e vrejtura te rezultojne nga heterogeniteti lokal ne deformim. Ne keto kushte, perdorimi i perqindjes se zgjatjes se kristaleve per te vleresuar ne menyre sasiore deformimin duhet te behet me kujdes. Ne do te kufizohemi ne kete studim, per te gjitha rastet e studiuara me poshte ne perdorimin e vlerave mesatare per te gjetur evolucionin e mundeshem si brenda nje facie po ashtu dhe nga nje facie ne tjetren.




Fig.8. Histogramat per facien lercolltike.




Fig.9. Histogramat per facien verlitike.

Nga te dhenat e mesiperme per kete facie, perqindja e zgjatjes te kristaleve eshte gjithmone me e madhe se 2; nga olivina ne piroksenet dhe ne kromitet verehet rritje e vogel. Ne me te shumten e rasteve zgjatja nuk lidhet thjesht me shtypje por me deformim ne terheqje. Kjo duket nga prania e mikrostrukturave te shumta te tipit te hapjes (pull a part). Nder tre mineralet e studiuara piroksenet kane permasa me te medha te kokrrizave (Fig.5).

**3.2- Deformimi ne harzburgit-dunite.** Vlerat mesatare te fituara nga studimi statistikor i mineraleve jepen ne Tab. n°2, kurse ato te stacioneve te observimit ne Fig. 3, 4. Zgjatja e kristaleve te olivinave per kete zone varion nga 1.9 deri 2.3 rralle deri ne 8 (Fig.6). Per piroksenet ajo ndryshon 1.7-2.8mm; per spinelin 1.7-3.2mm. Permasat e kokrizave variojne 0.6-1.7mm per olivinat; 1-1.6mm per pioroksenet dhe 0.3-0.8mm per spinelin (Fig.4). Si per madhesine e kokrizave po ashtu dhe per zgjatjen e kristaleve histogramat jane nje modale, me perjashtim te histogrames se madhesise se kokrizave te piroksenet ku vrehet nje maksimum i rendit te dyte te intervalit 3.2-4mm (Fig.6). Si perfundim olivinat dhe shpineli kane nje orientim te mire te formes dhe nje perqindje te zgjatjes se kristaleve me pak te rendesishme se piroksenet. Shperndarja e zgjatjes se kristaleve te çdo minerali te studiuar tregon qe intensiteti i deformimit ne brendesi te se nejtes zone eshte lokal (Fig.3).

**3.3- Deformimi ne dunitet.** Nga pikepamja hapesinore, kjo facie ndodhet mbi zonen kalimtare. Rezultatet e fituara tregojne se zgjatja e kristaleve te olivinave ne kete zone varion 1.6-2.3mm; te spinelit 1.3-3.2mm (Fig.3). Persa i perket permasave te kokrizave ajo ndryshon nga 0.5 deri ne 2.8mm per olivinat dhe 0.1 deri ne 0.4mm per spinelin kromifer (Fig.4). Histogramat e zgjatjes se kokrizave te olivinave dhe te spinelit jane nje modale. Ajo e madhesise se kokrizave te olivines paraqet nje maksimum te rendit te dyte (Fig.7), te lidhur me fenomenin e rikristalizimit te olivinave. Keshtu rezulton se intensiteti i deformimit ndryshon nga nje vend ne tjetrit, gje qe shpjegon karakterin e tij lokal. Zgjatja e kristaleve te olivines eshte me e madhe se e spinelit. Kjo ndoshta lidhet me ndjeshmerine e ndryshme ne deformim.

**3.4- Deformimi ne lercolitet dhe verlitet.** Lercolitet dhe verlitet takohen kriesisht ne zonen kalimtare midis duniteve dhe gabrove. Per lercolitet vlera mesatare e zgjatjes se kokrizave te olivines eshte 1.81; te pirokseneve 1.95 dhe spinelit 1.94, kurse madhesia e kokrizave eshte 0,83mm per olivinat; 1,57mm per piroksenet dhe 0,81mm per spinelin (Fig.8). Ne kete facie piroksenet dhe spineli kane nje zgjatje me te forte, kurse shmangia mid vlerave mesatare te zgjatjes nga nje vend ne tjetrit eshte e vogel. Pra, intensiteti i deformimit ne kete facie eshte i shperndare ne menyre pak a shume homogene. Persa i perket vehrlliteve histogramat ~ madhesise dhe te zgjatjes se kokrizave jane nje modale (Fig.9). Ketu piroksenet paraqiten me nje zgjatje me te madhe. Mbeshtetur ne dallimet faciale masivi ndahet ne dy njesi (Tab 1):

- Njesia e poshtme ku zgjatja e kristaleve te te gjitha mineraleve eshte me e madhe se dy. Kufiri i siperme i saj korespondon me kufirin e siperme te zones se kalimit harzburgit-dunit.
- Njesia e siperme ku zgjatja e kristaleve ne rastin e te gjitha mineraleve te studiuara eshte me e vogel se dy. Kufiri i kesaj zone korespondon me kufirin e poshtem te zones se kalimit dunit-harzburgit.
- Ne gabrot dhe gabro-dunitet vihet re qe zgjatja dhe madhesia e kristaleve te olivinave dhe te pirokseneve eshte me e vogel se ne dunitet qe vendosen poshtë tyre.

## PERFUNDIME

- Faciet petrografike kryesore qe takohen ne masivin ultrabazik te Kukesit jane: harzburgitet, dunitet me piroksen, dunitet, lercolitet, verlitet, vebsteritet me olivine, klinopiroksenet me olivine dhe gabro e gabro-noritet.
- Te dhenat kimike te mineraleve te studiuar (ol. + py) tregonje se nga pjeset me te poshteme te masivit ne drejtim te pirokseneve te zones kalimtare dhe te gabrove, olivinat behen gjithnj e me te pasura ne Fe dhe me te varfera ne Mg. Kjo deshmon per nje kristalizim te fraksionuar.
- Formacionet e masivit ultrabazik te Kukesit paraqesin nje shkalle relativisht te dobet te deformimit. Cikli i deformimit ndalet ne nivelin e mikrostrukturave porfiroklastike mesatarisht te rikristalizuara. Mikrostrukturat fluidale, millonitike dhe mozaike me rritje te ekzagjeruar nuk takohen ne masiv.
- Nenmikrostrukturat e takuara ne faciet e ndryshme petrografike flasin qarte per nje mbi-vendosje te dy tipeve te deformimit: te temperaturave te larta dhe te uleta. Kjo verehet qarte sidomos ne nenstrukturat e duniteve te fresketa.
- Sipas zgjatjes se kristaleve masivi mund te ndahet ne dy njesi me intensitet te ndryshme deformimi: a-njesia e poshteme me intensitet deformimi me te madh se dy; b-njesia e siperme me intensitet deformimi me te vogel se dy.
- Intensiteti i deformimit ndryshon jo vetem nga nje facie ne tjetren por dhe nga nje pike ne tjetren brenda se njejtës facie, pra ai ka nje karakter lokal.

## LITERATURA

- Boudier F. & Nicolas A., 1972 - Fusion partielle gabbroique dans la lherzolite de Lanzo (Alpes piemontaises). Bull. Suisse Miner. Petrol., 52, 39-56.
- Boullier A.M., 1977 - Struct. des perid. en encl. dans les Kimberl. d'Afrique du Sud. Cons. sur la const. du manteau sup. Bull. Soc. Fr. Min.Crist. 100.
- Caslli H., etj., 1968 - Studimi per masivin ultrabazik te Kukesit. F.Q. Gj. Tirane.
- Darot M. & Boudier F., 1975 - Min. lin. in def. perid.: kin. meaning: Petrol. I,(3).
- Gjata K., Goci L. 1981 - Tip. petr. metal. komp. Mird. VL, Bul. Shk. Gjeol. 2.
- Goci L., etj., 1981 - Ndert. gjeol. masivit Kukesit. Permb.Stud. nr.9-10.
- Kodra A. 1976 - Mbi moshen J te form. vull.-sed. te Mirdites. Permb. Stud. Nr.1.
- Nicolas A. & Poirier J.P., 1976 - Cristalline plasticity and solid state flow in metamorphic rocks. J.Wiley Interscience Publ., London, 444 pages.
- Nicolas A., Bouchez J., Bouier F. & Mercier J.C., 1971 - Text. struct. and fab. due to solid state flow in some Europ. Iherz. Tectonophysics, 12, 55-86.
- Nicolas A., Boudier F & Bouchez J.L., 1980 - Interpret. of peridotite structures from ophiolitic and oceanic environments. Amer. J. Sci. 280, 192-210.
- Nicolas A & Boudier F., 1975 - Cin. of folds in alp. perid. Tect. 25, p. 233-260.
- Raleigh C.B. & Kirby S.H., 1970 - Cr. in the up. man. Min. Soc. Am. S. Pap. 3.
- Streikensen A., 1973 - Plutonic rocks. Classification and nomenclature recommended by the I.U.G.S. subcommission on the systematics of igneous rocks. Geotimes, 18, 10, 26-30.

### Résumé

#### DONNÉES PÉTROLOGIQUES, MICROSTRUCTURALES ET DE L'INTENSITÉ DE DÉFORMATION DES ROCHES DU MASSIF ULTRABASIQUE DE KUKES.

Cette étude est réalisée à partir des échantillons orientés qui sont prélevés systématiquement sur l'ensemble du massif. La classification des différents faciès pétrographiques est basée sur la composition modale des roches. La composition chimique des minéraux étudiées à la microsonde électronique indique qu'en passant de la partie inférieure du massif (des harzburgites et des dunites), vers la partie supérieure (zone intermédiaire et gabbros) il y a une rupture au niveau de la composition chimique de ces minéraux pour les teneurs en Mg et Fe. Cette rupture est remarquée au niveau de la limite inférieure de la zone intermédiaire. Les olivines et les orthopyroxènes des harzburgites et des dunites sont beaucoup plus riches en magnésium que les olivines et les orthopyroxènes de la zone intermédiaire et des gabbros.

En passant de la base de la zone intermédiaire vers la partie supérieure des gabbros on observe une diminution graduelle de la teneur en magnésium et une augmentation de la teneur en fer. Ceci est en accord avec l'évolution (cristallisation fractionnée) d'un liquide dans une chambre magmatique qui se situe au-dessus des roches du manteau (harzburgites et dunites). Les microstructures observées sont: granoblastique équante; granoblastique tabulaire et porphiroclastique. Cette dernière est faiblement à moyenement recristallisée. La sous-structure observée dans les minéraux des différents faciès pétrographiques indique que ces faciès ont subit une déformation de haute température avec des traces de déformation de basse température. Le taux d'allongement des différents minéraux étudiés (olivine, pyroxènes, spinelle) permet de diviser le massif en deux unités : une unité inférieure qui a subit une déformation plus forte (le taux d'allongement des minéraux est supérieure à 2) et une unité supérieure moins déformée (le taux d'allongement des minéraux est inférieure à 2). La limite entre ces deux unités correspond à la limite supérieur de la zone de transition entre les harzburgites et les dunites.

# ASPEKTE TE NDERTIMIT MORFOLOGO-STRUKTUROR DHE TE PERSPEKTIVES TE FUSHES XEHERORE KROMITIKE THEKEN-TERNOVE-PYLLI I ZI


**Arjan Beqiri**, Fakulteti Gjeologji-Miniera, Universiteti Politeknik, Tirane.  
**Luan Hodobashi**, Ministria e Burimeve Minerare dhe Energetike, Tiarane.

Paraqiten te dhena mbi ndertimin morfologo-strukturor, pozicionin hapsinor te mineralizimit kromitik ne prerjen e shkembijnje ultrabazike te rajonit dhe marredheniet strukturorotektonike midis objekteve qe ndertojne fushen xeherore kromitike Theken-Ternove-Pylli i Zi. Mbi kete baze jepen edhe drejtimet e kerkimit te metejshem.

## Ndertimi gjeologo-strukturor i rajonit Theken-Ternove -Pylli i Zi.

Rajoni Theken-Ternove-Pylli i Zi ndodhet ne sektoret jugor te masivit ultrabazik te Bulqizes (Fig.1). Ne ndertimin gjeologjik te tij marrin pjesen kryesisht shkembijnje ultrabazike tektonite qe perhapen ne pjesen veri-verilindore te rajonit dhe pjeserisht kumulatet ultrabazike qe perhapen ne kufijte jugor-jugperendimor te tij (Fig.2). Nga poshte lart prerja e shkembijnje ultrabazike tektonite eshte si vijon : Harzburgite, harzburgit-dunite, dunit-harzburgite. Ne pjesen e siperme te prerjes ndeshen kumulatet ultrabazike e perfaquesuara nga dunitet, verlitet e piroksenitet.

**Tektonitet ultrabazike. Harzburgitet.** Zene pjesen me te madhe te rajonit. Shpesh paraqiten ne pamje brezore si rezultat i nderthurjes ritmike te brezave me te pasur dhe me te varfer me piroksen. Kane shkalle te ndryshme te deformimit plastik dhe te kataklazimit. Ne olivine shfaqen shuarjet valore apo brezat nyiore (kink-band). Shpesh pirokseni rombik paraqet perkulje te planeve te shpetezimit, ndersa kromiti aksesor tregon zgjatje dhe plasaritje te kokrrizave te tij. Nga vrojtimet makroskopike e mikroskopike rezulton se ne sektoret me veriore te rajonit, qe u takojne pjeseve me te poshtme te prerjes dhe ne pjeset me te thella, sipas te dhenave te shpimeve, harzburgitet jane relativisht me te pasura me piroksen (mbi 18%) dhe pak te serpentinizuar. Ne pjeset e siperme te prerjes drejt kufirit me kumulatet ultrabazike, ato behen me pak piroksenore, me te serpentinizuara dhe fenomeni i deformimit plastik ne to eshte i zbehte, duke u shprehur vetem me shuarje valore. **Dunitet** paraqiten me trajta thjerzore te zgjatura dhe ne pajtim me strukturen e harzburgiteve. Ne sektoret veriore e verilindore qe u takojne pjeseve me te thella te prerjes tektonite te shkembijnje ultrabazike dunitet takohen ne trajten e thjerzave dhe breznimeve te holla brenda harzburgiteve, me kalime graduale me ta, ndersa ne sektoret jugore e jugperendimor qe u takojne pjeseve me te siperme te prerjes tektonite sasia e brezave dhe e thjerzave dunitike shtohen dhe permasat e tyre rriten. Shkembijnje jane te serpentinizuar ne shkalle te ndryshme dhe reflektojne shkalle te ndryshme te deformimit plastik dhe kataklazimit qe ne pjeset me te siperme te prerjes tektonite behet me i dobet.



**Fig.1.** Plani skematik i masivit ultrabazik te Bulqizes me fushen xehore kromitike Theken-Ternove-Pylli i Zi. (sipas Hartes Gjeologjike 1: 200.000).

1. Dunite; 2. Peridotite; 3. Gabbro; 4. Shkembinj ultrabazike te fresket; 5. Kontakt gradual; 6. Zone tektonike.(Geological map of ultrabasic massif of Bulqiza. 1. Dunites; 2. Peridotites; 3. Gabbros; 4. Fresh ultrabasic rocks. 5.Gradual contact of rocks; 6. Tectonic zone).

**Kumulatet ultrabajike.** Perhapen ne sektoret jugore te rajonit; perfaqesohen nga dunitet, me pak nga verlitet e piroksenitet. Dunitet kumulate jane relativisht me te serpentinizuar dhe me te alternuar se ato tektonite (Shallo M. etj., 1989). Ato kanestruktura kumulative ku olivina paraqitet me kokrriza izometrike qe takohen sipas pikave treshe; ne to mungon deformimi plastik. romiti aksesor formon perqe-




Fig.2. Skema gjeologjike me vendosjen e trupave kromitike.

1-Harzburgite; 2-Dunite; 3-Elementet strukturor ne harzburgitet; 4-Element strukturor ne dunitet; 5-Zone tektonike; 6-Dalje kromitike ne siperfaqe; 7-Vendi i mundshem i trupit xheror; 8-Profil gjeologjik; 9-Kufiri midis kumulateve dhe tektoniteve ultrabajzik; 10-Projektioni i pjesave te trupave Veriori i II, III nen dyshemene e tektonikes (2).

ndrime ne trajte zinxhiresh apo breznimesh te qendrueshem. Verlitet veçohen ne thjera brenda dunateve kumulate, duke patur kalime graduale me to. Kane perhapje te paket dhe permasa te vogla. Kristalet e piroksenit vendosen ne menyre te shtratuar. Piroksenet perbejne fazen interkumulative, ndersa olivina paraqitet idiomorfë. Ne zona te ngushta verlitet kalojne gradualisht deri ne piroksenite.

**Shkembinje damarore.** Perfaqesohen nga piroksenitet, gabrot, mikrogabrot e me rralle nga dunitet. Kane marredhenie nderprerese me shkembinje rrethues, kontakte te prera, shpesh me ndryshime anesore. Kane gjatesi disa dhjetra metra dhe trashesi deri 2-3m. Drejt pjesave te siperme te tektoniteve, ne kufi me kumulatet vihet re shtimi i sasise dhe i permasave te damareve nderpreres piroksenitike dhe shfaqja e damareve nderpreres te llojeve bazike, ndersa ne fushen e kumulateve ultrabajzike keto behen edhe me te shpeshte.

### Ndertimi strukturor.


Per evidentimin e ndertimit struktur te shkembinje ultrabajzike jane marre ne konsiderate gjithe elementet e mundshem strukturore si breznimet planparalele e orientimet lineare te kristaleve te piroksenit, nderthurjet midis llojeve shkembore me kalime graduale ne njeri tjeterin, shliret, zinxhiret e breznimet e kromtit ne dunitet, si dhe trupat e kromtit.

Tektonitet ultrabajzike reflektojne ne pergjithesi ndertim monoklinal, me perkulje te vogla fleksurale, si dhe dukuri te rrudhosjes lokale (Fig.2). Ne sektoret perendimore (Theken) kjo strukture monoklinale ka shtrirje te pergjitheshme 280-300° dhe renia jugperendimore me kend 70-85°, ne kufijte e vendburimit Ternove behet gjerësore me renie jugore me kend 70-85°, ndersa ne sektoret juglindore (Pylli i Zi) ka shtrirje juglindore me azimut 115-140° dhe renie jugperendimore me kend 70-85° (Beqiri A. 1987, Huqi B. 1990, Stermasi Sh. etj. 1989, Hoxha I. etj., 1987).

Nga autore te ndryshem (Lena Q. etj., 1981) jepet ideja e nje strukture te rrudhosur deri te permbysur ne verilindje. Mendojme qe mungesa ne sektore te gjere e elementeve strukturore me renie te kundert, mungesa e difetencave te dukshme ne kendet e renies qe do çonin ne perfytirim e nje strukture te rrudhosur e te permbysur si dhe mosperseritja e aspektit petrologjik te pjesave jugore-jugperendimore edhe ne ato veri-verilindore kundreshtojne idene mbi pranine e nje strukture te rrudhosur te tektoniteve ultrabajzike ne kete rajon. Kalimi nga tektonitet ultrabajzike me renie jugperendimore ne kumulatet ultrabajzike me renie pergjithesish të verilindore behet nepermjet nje zone kalimtare me gjerësi rreth 200m te dunit-harcburgitit me renie nga jugperendimore ne kufi me tektonitet ultrabajzike ne vertikale e deri verilindore ne kufi me kumulatet ultrabajzike.

### Ndertimi morfologo-strukturor i trupave dhe pozicioni i mineralizimit kromistik


Fusha xeherore kromitike e ketij rajoni perbehet nga tre objekte: Theken, Ternove, Pylli i Zi ne te cilet jane takuar disa trupa kromitike te tipit metalurgjik, qe vendoset ne pjeset e siperme te prerjes tektonike te shkembinje ultrabajzike te rajonit te ndare ne kater nivele kromitike:



### **Fig.3. Prerja gjeologo-zbuluese.**

- 1- Dunite; 2- harzburgit; 3- damare gabro-piroksenite; 4- shkeputje tektonike; 5- kufiri midis niveleve harzburgit-dinitike e dunit-harcburgitike; 6- trup kromitit; 7- boshti i pritshem i trupit.

**Fig.4.** - Projeksin vertikal. a- i trupit Jugori i pare (Theken), Veriori (Ternove); b- i trupit Veriori i dye (Theken); c- i trupit Verior i trete (Theken).  
 1- Trup kromitik (Chromite body); 2- Zona tektonike (Tectonic zone); 3- Boshti i mundshem i trupit (Ore body axis).



a- Niveli i siperm i vendosur ne pjeset e mesme-te siperme te prerjes dunit-harcburgitike prane kufirit me kumulatet ultrabazike i perfaqesuar nga trupat jugore (Ternove), daljet kromitike jugore (Pylli i Zi) dhe trupat Nr. 1, 2 (Maja e Theknes). Jane trupa me pamje thjerezore e pseudoshtresore brenda thjerezave te trasha te dunateve duke patur kalime graduale me ta dhe per gjithesht pajtim strukturor me strukturen monoklinale te shkembinjve. Eshte relativisht i paqendrushem ne trashesi dhe permbajtje, me pykezime gjenetike ne shtrirje e ne renie. Perfaqesoheret nga kromite te varfera (deri 25% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>, rralle mbi 42% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>).

b- Niveli i dyte vendoset ne pjesen e poshteme te prerjes dunit-harcburgitike dhe perfaqesoheret nga trupi Jugori i pare (Theken), trupi Verior (Ternove) dhe trupi Verior (Pylli i Zi). Eshte me i qendrueshem dhe gjen zhvillim gjate gjithe shtrirjes te fushes xehore, duke perbere edhe nivelin me te rendesishem nga ana industriale. Ka forme pseudoshtresore. Ka vendosje monoklinale ne pajtim te plote me strukturen e shkembinjve ultrabazike. Rralle takohen fleksura te vogla ne planin e shtrirjes e te renies si dhe ndonje rrudhosje lokale (Fig.3.) Permban xehore kromiti te pasur.

c- Niveli i trete vendoset ne pjesen e siperme te prerjes harcburgit-dunitike dhe perfaqesoheret nga trupi Veriori i dyte (Theken). Eshte konturuar ne shtrirje rreth 1 km, me trashesi disa m ne qender te trupit. Ka forme tubore qe zhytet ne lindje me kend rreth 40° dhe ne perendim me kend rreth 15° (Hoxha I. etj., 1987). Permban xehor kromiti te pasur me teksture masive. Vende vende trashesia e tij bie dhe trupi merr pamje damarore duke u zgjatur ne planin e renies.

d- Niveli i poshtem vendoset ne pjeset e mesme-te siperme te prerjes harcburgit-dunitike dhe perfaqesoheret nga trupat e Theknes Veriore dhe "Ushtari". Trupat kromitike jane ne forme pseudoshtresore-damarore, nga te cilat trupi Veriori i trete zhytet ne juglindje me azimut 130° dhe kend 30-40°. Autore te ndryshem i vendosin ata ne pjeset e siperme te prerjes tektonite te shkembinjve ultrabazike te rajonit (Hallaci H. etj. 1989, Stermasi Sh. etj., 1989). Fakte te tillë, si struktura per gjithesht monoklinale ne te cilen vendosen keta trupa, vendosja e trupit Veriori i trete nen trupin Veriori i dyte ne sektoret lindore te vendburimit Theken (Fig.3) dhe ambienti krejtesisht harcburgitik me thjenza te rralla e te holla dunesht, perkundrazi mbeshtetin variantin e vendosjes te ketij niveli mineralizimi ne pjeset e mesme-te siperme te prerjes harcburgit-dunitike. Ne planin teresor krahas pajtueshmerise te trupave kromitike me strukturen monoklinale te shkembinjve ultrabazike verehen edhe raste te mospajtimit me te siç jane zhytja e forte lindore e trapave Veriori i dyte e Veriori i trete ne vendburimin Theken, por kjo zhytje nuk imitohet nga trupat e tjere (Fig.4. a,b,c).

Autore te ndryshem (Huqi B., 1990) hedhin idene e prezences te nje strukture te per gjitheshme te rrudhosur te mineralizimit kromitik ne kete rajon, por kjo kundershtohet nga struktura monoklinale e shkembinjve ultrabazike ku vendoset mineralizimi, mungesa e rezultateve per krahet lidhes midis trupave te zbuluar, mbylljet gjenetike te trupave kromitike ne planin e renies te evidentuara ne punimet minerare, format e ndryshme morfologo-strukturore te trupave xehore, ambientet e ndryshme petrologjike ne te cilet vendosen etj.

## Mardheniet midis objekteve dhe drejtimet perspektive

Nga krahasimi i prerjeve te objekteve Maja e Theknes, Theken, Ternove, Pylli i Zi (Fig.3. a,b,c,d,e,) rezulton se ata perfaqesojne shfaqje te veçanta te te njejtes fushe xehore me merdhenie tektonike-strukturore midis tyre (Fig.2), ku si nivel me i qendrushem-reper i mineralizimit paraqitet trupi Jugori i pare (Theken), Veriori (Ternove), Veriori (Pylli i Zi). Lidhja midis objekteve dhe paralelizimi i trupave te veçante ne nivele te caktuara mineralizimi mbeshtet nga keta faktore:

1- Kufiri i kumulateve ultrabazike qe sherben si reper i forte petrologjik. Trupat jugor vendosen rreth 150-200m ne kete kufi.

2- Ambjenti i njeje petrologjik dunit-harcburgitik ne te cilin vendosen nivelet e siperme kromitike (I, II) qe gjejne zhvillimin gjate gjithe shtrirjes te fushes xehore.

3- Evidentimi i tektonikave shkeputese rajonale (1,2,3) midis objekteve te mesiperme dhe prania e copave dhe blloqeve te kromit brenda zones tektonike nr.2 ne kufijt e vendburimeve Theken-Ternove.

4- Nderprerja e vazhdimesise se trupit Jugorë i parë (Theken) ne bllokun evarur dhe te trupit verior (Ternovë) në bllokun e shtruar të tektonikës.

5- Evidentimi në kufijtë e objekteve Ternovë-Pylli i Zi i kthesës që bën struktura e shkembinjve ultrabazikë që kontrollon vendosjen hapsinore te niveleve kromitike (I, II) (Sharra Xh. etj.,1990).

6- Vijueshmëria e vendosjes së trupave kromitike në prejen dunit-harcburgitike (I, II) që nga poshte lart bëhen më të paqëndrueshëm ne trashesi e përbajtje, si dhe ndërtimi monoklinal i tyre përgjithesisht në pajtim me strukturën e shkëmbinjve ultrabazike. Perspektiva e zhvilimit të mineralizimit kromitik paraqitet më e mirë në drejtim te fushës xehore dhe konkretisht:

- Për trupat jugorë: ne juglindje të vendburimit Ternova drejt Pyllit te Zi sipas daljeve kromitike të kanaleve jugperëndimorë, ndërsa në perëndim të vendburimit Thekën drejt Majës së Theknës sipas daljeve kromitike 1,2.

- Për nivelin Jugor i pare (Thekën) - Veriori (Ternovë): ne juglindje te vendburimit Ternovë drejt Pyllit te Zi sipas daljes kromitike të karierës dhe rezultateve të profilit 496, ndërsa në jug perëndim te vendburimit Thekën drejt Majzes së Theknës me një hap nga trupi 1 sa ai i fiksuar midis këtyre dy trupave në kufijtë e vendburimit Thekën.

Për trupin Veriori i dyte (Thekën): ne lindje drejt vendburimit Ternovë vazhdon ndjekja e tij sipas zhytjes me kend  $40^\circ$  nën tektoniken 2. Ne rast ndërprerje nga kjo tektonikë, vazhdimi i tij duhet kerkuar ne bllokun e varur me një hap zhvendosje sa amplituda e fiksuar per trupin Jugori i parë (Thekën) - Veriori (Ternovë). Ne jugperëndim të vendburimit Thekën drejt Majës së Theknës me zhvendosje tektonike dhe zhytje me kend rreth  $15^\circ$  sipas hapit me trupin Jugori i parë (Thekën) të fiksuar në kufijtë e vendburimit Thekën.

Për trupin Veriori i tretë (Thekën): drejt perëndimit vazhdon ndjekja normale në kufijtë e objektit Lugu i Gjatë, ndërsa drejt lindjes vazhdon ndjekja sipas zhytjes me kend  $40^\circ$  nën tektoniken 2. Në rast ndërprerje të tij nga kjo tektonikë arsytojmë si për Veriorin e dytë.

**Për trupin "Ushtari":** drejt perëndimit janë marrë rezultate negative që mmund të tregojnë përmbyllje gjenetike të tij, ndërsa drejt lindjes ndërpritet nga tektonika 2 dhe zhvillimi i tij në bllokun e varur i përgjigjet daljes kromitike të kanalit 20/89 në veri të vendburimit Tërnovë.

Kërkimi i niveleve të tjera te mundëshme kromitike duhet orientuar sipas daljeve kromitike ne sipërfaqe Dobrelle, Sheshi i Cukes etj), ose sipas rezultateve te shkeputura te shpimeve qofshin keto dhe te dobeta qe ne kete rast do te pranoheshin si relikte te kanaleve ushqyes te zgavrave te trupave te vendosur mesiper ose si relikte te trupave me thelle (Bernard L. Lago etj., 1981). Ne nje plan me plan me te gjere kerkimi i trupave te tjere te mundeshem mund te behet nepermjet rikonstruktimit te prerjeve ne analogji me prerjet e objekteve fqinje ku jane fiksuar keta trupa sic eshte rasti i objekteve te Liqenit te Sopeve apo Malit te Lopes ne veri te vendburimit Thekën.

### Perfundime dhe rekomandime

1- Ne ndertimin gjeologjik të rajonit Theken -Ternove-Pylli i Zi marrin pjese kryesisht shkembinjte ultrabajzike tektonite (harcburgitë, dunite) që përhapen ne pjeset veriore te rajonit dhe me pak shkembinjte ultrabajzike kumulate (dunite, verlite, verlite, piroksenite) qe perhapen ne kufijt jugore te tij.

2- Shkembinjte ultrabajzike tektonite ndertojnë një strukture per gjithesish monoklinale me fleksura dhe rrudhosje lokale brenda saj, ndërsa kumulatet ultrabajzike ne kufij me tektonitet ultrabajzike imitojnë ne per gjithesi strukturen e ketyre te fundit sidomos ne planin e shtrirjesh.

3- Ne prerjen e shkembinjve ultrabajzike te rajonit veçohen kater nivele kromitike qe nga poshte larte jane: kromitet e Theknes Veriore, Veriori i dyte (Theken); Jugori i pare (Theken)- Veriori (Ternove)- Veriori (Pylli i Zi) dhe trupat jugore, ku niveli i dyte dhe i trete jane me te rendesishem si per nga sasia edhe nga cilesia e xehoreve kromitike qe permbajne.

4- Objektet e veçante dhe trupat respektive te tyre perfaqesojne shfaqje te te njejtes fushe xehore me rraredhenie tektonike strukturore midis tyre.

5- Kerkimi i metejshem per zgjerimin e kontureve te fushes xehore duhet orientuar si ne ndjekjen e niveleve kromitike te njohur dhe ne zbulimin e trupave te tjere te rindj.

### LITERATURA

- Beqiraj A., Keta S. Sharra Xh., Saraçi M. etj. - Raport i punimeve ne vb Ternove.  
 Bernard L., Lago etc., 1981- Podiform chromite ore bodies: a genetic model.  
 Dobi A., 1981- Petrol. e masivit ultrab. te Bulqizes dhe krommbajta e tij.(Disert.)  
 Hallaçi H. etj., 1989 - Ligjesite e perqendrimit te mineralizimit kromitik ne masivet e brezit lindor te shkembinjve ultrabajzike. Bul.Shk.Gjeol. nr.4.  
 Hoxha I, m Hodobashi L. etj., 1987 - Raport gjeologjik mbi punimet e kerkim-zbulimit dhe shfrytezimit ne v.b. e kromit Theken.  
 Huqi B. etj., 1990 - Projekt i punimeve te kerkim-zbulimit ne v.b. e kromit Temove.

- Johan Z. Ohnenstetter, 1988** - a comprehensive for the genesis of chromite deposits within the ophiolitic upper mantle. (Abstract).
- Lleshi B., 1990** - Mbi ndertimin gjeologo-strukturor dhe mineralmbajtja e pjeses gendrore te masivit dunitik te Martaneshit. Bul. Shk. Gjeol. nr.1.
- Qoku E., Lena Q., 1981** - Projekt i punimeve gjeologo-zbuluese te v.b. Theken.
- Stermasi Sh. etj., 1989** - Vendosja e mineralizimit kromitik ne masivin ultrabazik te Bulqizes dhe veçorite strukturore te vendburimeve. Bul. Shk. Gjeol. nr.4.
- Shallo M. etj., 1989** - Petrol. shkembinje ultrab. te brezit lindor dhe ligjesite perqendrimit te mineralizimit te kromit. I.S.P.Gj.

## ABSTRACT

### **Some aspects of morphological - structural setting and the perspective of the chromitic ore's field of Theken-Ternove Pylli i Zi**

In Theken-Ternove- Pylli i Zi Region are developed the ultrabasic tectonites (harzburgites and dunites). They are distributed in northern-north-eastern sectors of the region and represent the deepest levels of magmatic section. The cumulates (dunites, verlites, pyroxenites) are situated in southern-south western sectors and occupy the upper levels of the magmatic section. Ultrabasic tectonites reflect generally a monoclinal structure with a south-southwestern fall, some small flexures and local folds are also observed. Ultramafic cumulates in relation to ultrabasic tectonites imitate generally their structure, overall in plane extension. In this region are discovered some ore bodies separated in four chromitic levels. This distinction is based in their petrologic environment, morphological-structural particularites.

First level is represented by southern bodies;

Second level is represented by the first Southern Body (Theken) - Veriori (Ternove), Veriori (Pylli i Zi);

Third level - belong to Veriori II (Theken).

Fourth level is precised as Veriori III (Theken) - Ushtari (Theken Ternove).

The chromitic bodies manifest variations concerning their thikness and Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> content. These variations are seen in extension and in dipping. The monoclinal structure is characterixed by south-southwestern dipping being generally in conformity with monoclinal structure of ultrabasic rocks. In some occasions, structural unconformities between chromitic mineralization, and ultramafic rocks are seen.

From the comparision of Maja Theken, Theken-Ternove, Pylli i Zi section results that these ones represent particular outcrops of the some ore field being in tectonic-structural relations between them. The second level is the most consistent. The base cumulate dunites are considered as a petrologic marker, lying 150-200 m over southern ore bodies (first level). The ore prospecting works must be continued to the research of the known chromitic bodies and the new ones following their outcrops.